



REPUBLIKA E SHqipëRIË
MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

RAPORTI VJETOR

FINANCAT PUBLIKE VENDORE

2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DHE EKONOMISË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT

DREJTORIA E FINANCAVE VENDORE

Raporti Vjetor

Financat Publike Vendore

Maj 2023

Ky raport është përgatitur me mbështetjen e projektit 'Financat Lokale' nga Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike SECO

FINANCATLOKALE | Forcimi i Menaxhimit
LOCALFINANCES | të Financave Publike
të Qeverisjes Vendore



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati Zviceran i Shtetit për Çështje Ekonomike, SECO

PËRMBAJTA

Përmbledhje Ekzekutive	10
1. Hyrje në raportin e treguesve fiskalë vendorë 2022	17
2. Treguesit fiskalë të pushtetit vendor 2022	21
2.1 Të ardhurat e pushtetit vendor.....	28
2.2 Shpenzimet e pushtetit vendor.....	51
2.2.1 Shpenzimet dhe të ardhurat e NJVQV-ve sipas popullsisë.....	70
2.2.2 Shpenzimet e personelit për numër punonjësish sipas NJVQV-ve.....	82
2.3 Detyrimet e prapambetura.....	90
2.3.1 Të ardhurat e trashëguara dhe ndikimi në detyrimet e prapambetura.....	93
3. Menaxhimi Financiar Publik në nivel vendor dhe Autonomia Fiskale Vendore 2022	96
3.1 Të ardhurat e veta vendore ndaj totalit të të ardhurave të NJVQV-ve.....	98
3.2 Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme ndaj të ardhurave të veta të pushtetit vendor.....	100
3.3 Transferta e pakushtëzuar sektoriale ndaj të ardhurave të veta të pushtetit vendor.....	102
3.4 Shpenzimet e personelit ndaj transfertës së pakushtëzuar.....	104
3.5 Shpenzime kapitale ndaj transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme.....	106
3.6 Shpenzime kapitale ndaj të ardhurave të veta vendore.....	108
3.7 Detyrimet e prapambetura ndaj totalit të ardhurave të veta vendore.....	110
3.8 Detyrimet e prapambetura ndaj planit të shpenzimeve vjetore.....	112
3.9 Transferta e buxhetit qendror ndaj të ardhurave të veta vendore.....	114
4. Decentralizimi dhe treguesit fiskalë vendorë krahasuar me vendet e rajonit dhe OECD	116
5. Përfundime dhe Rekomandime	125
6. Analiza e treguesve fiskalë sipas njësive të vetëqeverisjes vendore	130
6.1 Treguesit e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas njësive të vetëqeverisjes vendore.....	130
152 Bashkia Belsh.....	131
102 Bashkia Berat.....	132
103 Bashkia Bulqizë.....	133
110 Bashkia Cërrik.....	134
104 Bashkia Delvinë.....	135
105 Bashkia Devoll.....	136
106 Bashkia Dibër.....	137
147 Bashkia Divjakë.....	138

452	Bashkia Dropull.....	139
107	Bashkia Durrës.....	140
109	Bashkia Elbasan.....	141
111	Bashkia Fier.....	142
326	Bashkia Finiq.....	143
155	Bashkia Fushë-Arrëz.....	144
115	Bashkia Gjirokastër.....	145
114	Bashkia Gramsh.....	146
117	Bashkia Has.....	147
160	Bashkia Himarë.....	148
166	Bashkia Kamëz.....	149
118	Bashkia Kavajë.....	150
154	Bashkia Këlcyrë.....	151
654	Bashkia Klos.....	152
120	Bashkia Kolonjë.....	153
156	Bashkia Konispol.....	154
122	Bashkia Korçë.....	155
123	Bashkia Krujë.....	156
124	Bashkia Kuçovë.....	157
125	Bashkia Kukës.....	158
126	Bashkia Kurbini.....	159
127	Bashkia Lezhë.....	160
116	Bashkia Libohovë.....	161
128	Bashkia Librazhd.....	162
129	Bashkia Lushnjë.....	163
130	Bashkia Malësi e Madhe.....	164
168	Bashkia Maliq.....	165
132	Bashkia Mallakastër.....	166
131	Bashkia Mat.....	167
143	Bashkia Memaliaj.....	168
132	Bashkia Mirditë.....	169
112	Bashkia Patos.....	170
134	Bashkia Peqin.....	171
135	Bashkia Përmet.....	172
136	Bashkia Pogradec.....	173
140	Bashkia Poliçan.....	174
153	Bashkia Prrenjas.....	175
137	Bashkia Pukë.....	176
499	Bashkia Pustec.....	177
119	Bashkia Rrogozhinë.....	178

113	Bashkia Roskovec.....	179
137	Bashkia Sarandë.....	180
159	Bashkia Selenicë.....	181
108	Bashkia Shijak.....	182
141	Bashkia Shkodër.....	183
139	Bashkia Skrapar.....	184
142	Bashkia Tepelenë.....	185
101	Bashkia Tiranë.....	186
145	Bashkia Tropojë.....	187
167	Bashkia Dimal.....	188
157	Bashkia Vau i Dejës.....	189
146	Bashkia Vlorë.....	190
165	Bashkia Vorë.....	191

7.Analiza e buxheteve sipas Këshillave të Qarqeve në të ardhura dhe shpenzime.....192

042	Këshilli i Qarkut Berat.....	193
046	Këshilli i Qarkut Dibër.....	193
047	Këshilli i Qarkut Durrës.....	194
048	Këshilli i Qarkut Elbasan.....	194
049	Këshilli i Qarkut Fier.....	195
011	Këshilli i Qarkut Gjirokastër.....	195
018	Këshilli i Qarkut Kukës.....	196
020	Këshilli i Qarkut Lezhë.....	196
033	Këshilli i Qarkut Shkodër.....	197
035	Këshilli i Qarkut Tiranë.....	197
037	Këshilli i Qarkut Vlorë.....	198
015	Këshilli i Qarkut Korçë.....	198

LISTA E TABELAVE DHE GRAFIKËVE

Tabela 1: Treguesit fiskalë të realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve vendore.....	22
Grafiku 1: Krahasimi i planit dhe realizimit faktik vjetor 2022 të të ardhurave dhe shpenzimeve sipas treguesve fiskal.....	24
Grafiku 2: Trendi i të ardhurave dhe shpenzimeve diskrete mujore të pushtetit vendor gjatë vitit 2022.....	25
Grafiku 3: Krahasimi i të ardhurave nga taksat vendore dhe shpenzimeve të pushtetit vendor 2015/2022.....	26
Grafiku 4: Financimi i pushtetit vendor në vite sipas burimit të të ardhurave.....	27
Grafiku 5: Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore dhe ecuria e ndryshimit në vite.....	28
Grafiku 6: Të ardhurat e veta vendore ndaj të ardhurave publike dhe PBB-së në vite.....	29
Grafiku 7: Të ardhurat tatimore dhe jotatimore të pushtetit vendor në vitin 2021 dhe 2022.....	30
Grafiku 8: Peshë sipas natyrës së të ardhurave në vitin 2022, sipas bashkive.....	31
Grafiku 9: Të ardhurat e veta vendore të pushtetit vendor sipas burimit gjatë vitit 2022/2021.....	32
Grafiku 10: Peshë e të ardhurave të veta vendore sipas burimit gjatë vitit 2022/2021.....	33

Grafiku 11: Peshë e të ardhurave sipas bashkive dhe burimit për vitin 2022.....	34
Grafiku 12: Të ardhurat e veta vendore në vite sipas burimit.....	35
Grafiku 13: Të ardhurat e grupuara në nivelin e taksave dhe tarifave vendore 2022 dhe 2021.....	36
Grafiku 14: Të ardhurat nga taksa e pasurisë së paluajtshme në vite.....	37
Grafiku 15: Të ardhurat nga taksat e pasurisë sipas burimit në vitin 2022 dhe 2021.....	38
Grafiku 16: Taksat mbi pasurinë sipas peshave gjatë vitit 2022 dhe 2021.....	39
Grafiku 17: Përbërja e të ardhurave nga taksat mbi pasurinë për vitin 2022, sipas bashkive.....	40
Grafiku 18: Taksat e tjera vendore sipas vlerave gjatë vitit 2022 dhe 2021.....	41
Grafiku 19: Taksat e tjera vendore sipas peshave gjatë vitit 2022 dhe 2021.....	42
Grafiku 20: Të ardhurat nga tatim fitimi mbi biznesin e vogël.....	43
Grafiku 21: Të ardhurat nga tarifatat e shërbimeve vendore.....	43
Grafiku 22: Të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë.....	44
Grafiku 23: Transferatat e Pakushtëzuar e pushtetit vendor në vite.....	45
Grafiku 24: Ndryshimi i të ardhurave të veta vendore 2022/2021 sipas bashkive.....	46
Grafiku 25: Peshë e të ardhurave sipas bashkive ndaj totalit të të ardhurave vendore 2022.....	48
Grafiku 26: Peshë e të ardhurave sipas bashkive ndaj totalit të të ardhurave vendore 2022, pa përfshirë bashkinë Tiranë.....	50
Grafiku 27: Shpenzimet e pushtetit vendor në vite dhe trendi i rritjes.....	51
Grafiku 28: Shpenzimet vendore në vite, në raport me shpenzimet publike dhe produktin e brendshëm bruto.....	52
Grafiku 29: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike të buxhetit vendor 2022/2021.....	53
Grafiku 30: Peshë e shpenzimeve sipas natyrës ekonomike të pushtetit vendor për vitet 2022/2021.....	54
Grafiku 31: Peshë e shpenzimeve të njërive të vetëqeverisjes vendore sipas llogarive ekonomike 2022.....	55
Grafiku 32: Peshë e shpenzimeve sipas natyrës funksioneve të pushtetit vendor për vitet 2022/2021.....	56
Grafiku 33: Ndryshimi i shpenzimeve sipas funksioneve të pushtetit vendor 2022/2021.....	57
Grafiku 34: Burimet e financimit të funksioneve vendore gjatë vitit 2022.....	58
Grafiku 35: Peshë e shpenzimeve sipas natyrës së funksioneve të pushtetit vendor në nivel bashkie në vitin 2022.....	59
Grafiku 36: Ndryshimi i shpenzimeve sipas funksioneve dhe burimit të financimit gjatë viteve 2022/2021.....	60
Grafiku 37: Peshë e shpenzimeve të pushtetit sipas burimit të financimit për vitet 2022/2021.....	61
Grafiku 38: Peshë e shpenzimeve në nivel njësie sipas burimit të financimit për vitet 2022/2021.....	62
Grafiku 39: Ndryshimi i shpenzimeve sipas njërive të vetëqeverisjes vendore 2022/2021.....	64
Grafiku 40: Peshë e shpenzimeve të njërive të vetëqeverisjes vendore ndaj totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor 2022.....	65
Grafiku 41: Peshë e shpenzimeve të njërive të vetëqeverisjes vendore (pa bashkinë Tiranë) ndaj totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor 2022.....	66
Grafiku 42: Shpenzimet e bashkive mbi 100 mijë banorë sipas llogarive ekonomike 2022 dhe ndryshimeve 2022/2021.....	67
Grafiku 43: Shpenzimet e bashkive me 50 mijë - 100 mijë banorë sipas llogarive ekonomike 2022 dhe ndryshimeve 2022/2021.....	68
Grafiku 44: Shpenzimet e bashkive nën 50 mijë banorë sipas llogarive ekonomike 2022 dhe ndryshimeve 2022/2021.....	69
Grafiku 45: Shpenzimet për banorë sipas kategorive të natyrës ekonomike për vitin 2022.....	71
Grafiku 46: Ndryshimi i shpenzimeve për banorë ndërmjet 2022/2021.....	72
Grafiku 47: Shpenzimet e personelit për banorë gjatë vitit 2022.....	75
Grafiku 48: Shpenzimet e investimeve për banorë gjatë vitit 2022.....	77
Grafiku 49: Ndryshimi i të ardhurave për banorë sipas bashkive 2022/2021.....	79
Grafiku 50: Të ardhurat sipas njërive të vetëqeverisjes vendore për banorë gjatë vitit 2022.....	81
Grafiku 51: Numri i punonjësve sipas bashkive gjatë vitit 2022.....	83
Grafiku 52: Ndryshimi i numrit të punonjësve sipas bashkive gjatë vitit 2022/2021.....	85
Grafiku 53: Shpenzimet e personelit për punonjës të njërive të vetëqeverisjes vendore 2022.....	87
Grafiku 54: Ndryshimi i pagës mesatare për punonjës në nivel bashkie 2022/2021.....	89
Grafiku 55: Detyrimet e prapambetura të pushtetit vendor në vite.....	91
Grafiku 56: Peshë e detyrimeve të prapambetura të pushtetit vendor sipas natyrës.....	91
Grafiku 57: Trashëgimi i fondeve sipas burimit gjatë vitit 2022.....	93

Grafiku 58: Të ardhurat e veta vendore ndaj totalit të të ardhurave sipas bashkive 2022.....	99
Grafiku 59: Transferta e pakushtëzuar ndaj të ardhurave të veta sipas bashkive 2022.....	101
Grafiku 60: Transferta e pakushtëzuar sektoriale ndaj të ardhurave të veta vendore sipas bashkive 2022.....	103
Grafiku 61: Shpenzimet e personelit ndaj transfertës së pakushtëzuar sipas bashkive 2022.....	105
Grafiku 62: Shpenzimet kapitale ndaj transfertës së pakushtëzuar sipas bashkive 2022.....	107
Grafiku 63: Shpenzimet kapitale ndaj të ardhurave të veta vendore sipas bashkive 2022.....	109
Grafiku 64: Detyrimet e prapambetura ndaj totalit të ardhurave të veta vendore sipas bashkive 2022.....	111
Grafiku 65: Detyrimet e prapambetura ndaj planit të shpenzimeve vjetore sipas bashkive 2022.....	113
Grafiku 66: Transferta e buxhetit qendror ndaj të ardhurave të veta vendore sipas bashkive 2022.....	115
Grafiku 67: Transferrat ndërqeveritare ndaj totalit të të ardhurave të pushtetit vendor (2021).....	118
Grafiku 68: Transferrat ndërqeveritare ndaj produktit të brendshëm bruto (2013-2021).....	119
Grafiku 69: Transferrat ndërqeveritare ndaj shpenzimeve publike (2013-2021).....	120
Grafiku 70: Shpenzimet vendore ndaj Produktit të Brendshëm Bruto (2013-2021).....	121
Grafiku 71: Shpenzimet vendore ndaj totalit të shpenzimeve publike (2013-2021).....	122
Grafiku 72: Të ardhurat e veta vendore ndaj Produktit të Brendshëm Bruto (2013-2021).....	123
Grafiku 73: Të ardhurat e veta vendore ndaj të ardhurave publike (2013-2021).....	124

LISTA E SHKURTIMEVE

MFE	Minsitria e Financave dhe Ekonomisë
AFMIS	Albanian Financial Management Information System
NJVQV	Njësi të Vetëqeverisjes Vendore
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
OECD	Organisation for Economic Co-operation and Development
SIFQ	Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm



Përmbledhje Ekzekutive

Krjimi i një pushteti vendor të fortë financiarisht por edhe me kapacitete njerëzore të qëndrueshme është një tregues i rëndësishëm që siguron cilësi në standardin e jetesës së qytetarëve. Treguesit fiskalë të vitit 2022, evidentojnë qartë rritjen e qëndrueshme të të ardhurave dhe shpenzimeve të pushtetit vendor. Thellimi i decentralizimit dhe sigurimi i shërbimeve vendore të një cilësie sa më të lartë është objektiv strategjik i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Përmirësimi i ecurisë tashmë nuk mjafton vetëm nga viti në vit, por është i domosdoshëm krahasimi me vendet e tjera të zhvilluara të Europës ku Shqipëria tashmë e ka prioritet kombëtar të bëhet pjesë.

Në raport me treguesit kombëtar të pushtetit vendor për vitin 2022, në këtë analizë janë evidentuar treguesit kryesorë fiskalë dhe të autonomisë si më poshtë:

- Të ardhurat vendore janë rreth **4.79% të të ardhurave publike dhe rreth 1.34% të produktit të brendshëm bruto**. Krahasuar me trendin e një viti më parë, në raport me të ardhurat publike ato kanë rënë me rreth 0.43%.
- Të njëjtin trend rënës të ardhurat vendore kanë patur edhe ndaj produktit të brendshëm bruto, **ku nga 1.41% që ishin në vitin 2021 kanë arritur në 1.34% në vitin 2022 ose rreth 0.07% më pak**.
- Pushteti vendor ka realizuar shpenzime sa **3.01% e Produktit të Brendshëm Bruto** dhe **sa 9.39% të totalit të shpenzimeve publike**.
- Në vitin 2022, pushteti vendor ka përfituar në formën e **transfertave rreth 29.8 miliard lekë ose rreth 1.7% më shumë se një vit më parë**.
- Sipas natyrës së transfertës **rreth 62.8% ose 18.7 miliard lekë** pushteti vendor e merr në formën e transfertës së pakushtëzuar e cila shpërndahet sipas formulës së përcaktuar me ligj.
- Në 2 muajt e fundit të vitit 2022, konstatohet një kapërcim jo normal i trendit të shpenzimeve me rreth **15.4 miliard lekë shpenzime ose 26% të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor**.
- Në vitin 2022, pushteti vendor realizon rreth **24.6 miliard lekë ose 72.3% më shumë shpenzime** për financimin e funksioneve të përcaktuara në ligj krahasuar me vitin 2015.
- Për të njëjtën periudhë, pushteti vendor siguron rreth **16.2 miliard lekë ose 138% më shumë** të ardhura nga taksat dhe tarifatat vendore.
- Stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të muajit dhjetor 2022, është rreth **5.4 miliard lekë**.
- Stokun më të lartë të detyrimeve të prapambetura e ka Bashkia Tiranë në vlerën rreth **1.1 miliard lekë**, e cila përbën 19.7% të totalit të detyrimeve. Ndërkohë në nivel vendor peshën më të madhe të stokut të detyrimeve e zë **kategoria "Investime" me 49.7%**.
- Nga viti 2022, pushteti vendor ka trashëguar rreth **28.8 miliard lekë nga të cilat 23.6 miliard lekë ose 82.3%** janë trashëgim nga buxheti i vetë njëjësive

vendore dhe pjesa tjetër prej **6.2 miliard lekë ose 17.7% janë fonde të trashëguara nga procesi i rindërtimit.**

- Në fund të vitit 2022 kanë trashëguar më shumë fonde rreth 34 bashki nga të cilat vetëm bashkia **Tiranë ka trashëguar rreth 14 miliard lekë ose gjysmën e totalit të fondeve të trashëguara.**
- Gjatë vitit 2022, të ardhurat e veta vendore ndaj totalit të ardhurave janë **rreth 51.5%.**
- Transferta e pakushtëzuar e shpërndarë me formulë **në vitin 2022 është 60.3%** e të ardhurave të veta të njërive të vetëqeverisjes.
- Raporti i transfertës së pakushtëzuar sektoriale me të ardhurat e veta të njërive të vetëqeverisjes vendore **është rreth 30%.**
- **Shpenzimet e personelit të njërive të vetëqeverisjes vendore janë rreth 135% e transfertave të buxhetit qendror** në formën e transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme. Ndërkohë që shpenzimet kapitale **zënë vetëm 63.6% të transfertës së pakushtëzuar.**
- Pushteti vendor ka realizuar rreth **11.9 miliard lekë shpenzime për investime** dhe në raport me **të ardhurat e veta vendore** këto shpenzime zënë **vetëm 38.3%.**
- Gjatë vitit 2022, raporti i stokut të **detyrimeve të prapambetura prej rreth 5.4 miliard lekë,** ndaj totalit të të ardhurave të veta faktike rezulton të jetë prej **rreth 19%.**
- Stoku i **detyrimeve të prapambetura zë rreth 7% të totalit të planit të shpenzimeve të njërive të vetëqeverisjes vendore.** Krahasuar me një vit më parë stoku i detyrimeve të prapambetura është zvogëluar me rreth **1.2 miliard lekë ose 18%.**

Një aspekt i rëndësishëm janë të ardhurat e pushtetit vendor për vitin 2022, si rrjedhojë në këtë analizë janë evidentuar treguesit e të ardhurave sipas burimit për pushtetin vendor:

- Pushteti vendor ka mbledhur të ardhura të veta rreth **30.9 miliard lekë nga të cilat rreth 27.6 miliard lekë ose 89.2% e zënë të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore dhe pjesa tjetër prej 3.3 miliard lekë ose 10.8% janë të ardhurat jotatimore të pushtetit vendor.**
- Në vitin 2022, pushteti vendor konsolidoi trendin e rritjes së të ardhurave të veta **me rreth 1.4 miliard lekë ose rreth 5% më shumë se një vit më parë.**
- Burimi me peshën më të madhe në të ardhurat vendore gjatë vitit 2022, është taksat e ndikimit mbi infrastrukturë me rreth 33% të të ardhurave të veta vendore. Pavarësisht se në nivel agregat ky burim është më i rëndësishmi për pushtetin vendor, **në nivel njësie rreth 72.9% e mbledh vetëm Bashkia Tiranë.**

- **Rreth 29% të totalit të të ardhurave të veta vendore ose 9 miliard lekë** pushteti vendor i ka mbledhur nga tarifat vendore, ndërkohë pjesa tjetër prej 71% janë nga taksat vendore.
- Nga 6.1 miliard lekë të mbledhura në nivel vendor nga taksat mbi pasurinë, **Taksa mbi ndërtesën zë rreth 73.4% të totalit të këtij grupi**, ndërkohë Taksa mbi tokën bujqësore 9.5%, Taksa mbi turallin 4.1% dhe Taksa mbi transaksionet e kryera me pasuritë e paluajtshme. Në vitin 2022 janë rritur të ardhurat nga transaksioni i pasurive të paluajtshme me rreth 2% më shumë.
- Të ardhurat e veta vendore në 21 bashki ose 34.4% **të bashkive të Shqipërisë kanë rënie në raport me një vit më parë**, ndërkohë pjesa tjetër prej 40 bashkive kanë patur rritje të të ardhurave të veta.
- Bashkitë me rënien më të madhe janë **bashkia Patos me rreth 47% ose 89 milion lekë më pak së në vitin 2021**. Më pas bashkitë **Këlcyrë dhe Selenicë kanë një rënie me rreth 30% dhe 24% ose rënie në vlerë absolute përkatësisht 4 milion lekë dhe 20 milion lekë**.
- Në vlerë absolute rritjen më të madhe për vitin 2022 e ka bashkia Tiranë me rreth **533 milion lekë më shumë krahasuar me vitin 2021**. Bashkitë e tjera të cilat kanë një rritje të konsiderueshme në raport me vitin 2021 janë **bashkia Kamëz me rreth 250 milion lekë dhe bashkia Vlorë me rreth 230 milion lekë**.
- Bashkia Tiranë, ka mbledhur rreth 17.3 miliard lekë të ardhura të veta vendore ose rreth 56.1% të të ardhurave të pushtetit vendor. **Ndërkohë që i gjithë pushteti vendor ka siguruar nga burime të qëndrueshme të të ardhurave nga taksat mbi pasurinë rreth 6.1 miliard lekë, vetëm bashkia Tiranë nga këto burime ka siguruar 2.9 miliard lekë ose 47% të këtij burimi të të gjithë pushtetit vendor**.
- **11 bashkitë me mbi 100 mijë banorë ose 18% e bashkive kanë akumuluar gjatë vitit 2022 rreth 24 miliard lekë ose ndryshe rreth 80% të totalit të të ardhurave të pushtetit vendor**.
- Bashkitë më një popullsi nga **50 mijë-100 mijë banorë ose 13 bashki (21% e totalit të bashkive)** kanë mbledhur vetëm 2.7 miliard lekë ose 8.7% të totalit të të ardhurave vendore.
- Bashkitë me **nën 50 mijë banorë janë 37 ose 61 % e totalit të bashkive, ku gjatë vitit 2022 kanë mbledhur vetëm 3.4 miliard lekë ose 11.3% të totalit të të ardhurave të pushtetit vendor**.
- **Pushteti vendor në vitin 2022 mesatarisht ka mbledhur 5,156 lekë për banor**, ose ndryshe rreth 341 lekë më shumë të ardhura të mbledhura për banor në krahasim me vitin 2021.
- **Rreth 23 bashki**, në vitin 2022 kanë një rënie të barrës fiskale për banor krahasuar me një vit më parë, **ku rënien më të madhe të barrës fiskale e ka bashkia Mallakastër me rreth 3,103 lekë, Shijak 2,523 lekë dhe bashkia Vorë me 1,322 lekë**.

- **38 bashki** kanë patur një rritje të të ardhurave të veta vendore për banor gjatë vitit 2022, **ku rritjen më të madhe e ka patur Bashkia Klos 5,730 lekë, Bashkia Cërrik 3,839 lekë dhe Bashkia Rrogozhinë 3,142 lekë.**
- Bashkitë të cilat kanë një popullsi mbi 100 mijë banorë (11 bashki), gjatë vitit 2022 kanë mbledhur mesatarisht **rreth 7,742 lekë për banor.**
- **Ndërkohë, bashkitë me popullsi ndërmjet 50–100 mijë banorë (13 bashki) kanë mbledhur mesatarisht vetëm 3,641 lekë për banor.**
- Bashkitë me popullsi nën **100 mijë banorë (37 bashki) kanë mbledhur mesatarisht rreth 4,919 lekë për banor ose më shumë se kategoria e dytë e bashkive mbi bazën e popullsisë.**
- Bashkia Himarë ka vlerën më të madhe të të ardhurave për banor me **rreth 45,817 lekë, pas saj Bashkia Tiranë 26,704 lekë dhe bashkia Sarandë me rreth 15,649 lekë.**
- Ndërkohë, bashkitë me nivelin më të ulët të të ardhurave për banor janë **bashkia Kurbin me 953 lekë për banor dhe bashkia Has me 969 lekë për banor.**

Treguesit e shpenzimeve vendore gjatë vitit 2022 janë një aspekt i rëndësishëm i menaxhimit financiar, si më poshtë janë evidentuar disa nga pikat kryesore të këtyre treguesve:

- Në vlerë absolute buxheti vendor ka realizuar **58.6 miliard lekë.** Krahasuar me një vit më parë shpenzimet vendore janë **6.1 miliard lekë ose 11.6% më shumë.**
- Shpenzimet e personelit zënë rreth **43% të totalit të shpenzimeve vendore.** Në raport me një vit më parë këto shpenzime kanë një rritje rreth **1.09 miliard lekë.**
- Shpenzimet për investime gjatë vitit 2022 zënë rreth **20.3% të totalit të shpenzimeve vendore.** Në raport me një vit më parë konstatohet që **shpenzimet për investime kanë një rritje me rreth 630 milion lekë.**
- Shpenzimet operative në vitin 2022, zënë rreth **31.9% të totalit të shpenzimeve vendore.** Vlen të theksohet fakti që gjatë vitit 2022 shpenzimet operative janë rritur **me rreth 3 miliard lekë** krahasuar me shpenzimet e vitit 2021.
- Pushteti vendor ka financuar në pjesën më të madhe të buxhetit funksionin e **“Shërbimeve të përgjithshme publike”** dhe **“Arsimit”, përkatësisht në masën 22% dhe 19%**
- Funksionet që kanë patur rritje të shpenzimeve gjatë vitit 2022 janë **“05-Mbrojtja e mjedisit” me një rritje prej 2%** dhe pothuasje të njëjtën përqindje rritje ka patur shpenzimet për funksionin **“08-Argëtimi, Kultura dhe Feja”.**

- Funkcionet me rënien më të madhe krahasuar me vitin 2021 **e kanë pësuar ato të “01-Shërbimet e Përgjithshme Publike” dhe “09-Arsimi” me rreth 1%.**
- Vetëm **9 bashki nga totali kanë patur një rënie të shpenzimeve në vitin 2022 në raport me shpenzimet e realizuara në vitin 2021.**
- Bashkitë me rënien më të madhe janë bashkitë **Tropojë me një rënie prej 13%, bashkia Gramsh me rreth 9% apo bashkia Delvinë me rreth 8%** të shpenzimeve.
- **52 bashki** kanë patur të njëjtat shpenzime ose rritje të shpenzimeve në vitin 2022 në raport me vitin 2021.
- **6 bashki kanë patur rritje të shpenzimeve nga 0%-3%;**
- **17 bashki kanë patur rritje të shpenzimeve vendore nga 4%-10%;**
- **16 bashki** kanë patur rritje të shpenzimeve nga **11%-19% dhe 13 bashki kanë patur rritje mbi 20%.**
- Bashkitë të cilat kanë patur rritjen më të madhe të shpenzimeve gjatë vitit 2022 janë **bashkia Kukës me 45% apo bashkia Malësi e Madhe me 37%.**
- **Rreth 30.5%** të totalit të shpenzimeve të buxhetit vendor e zë Bashkia Tiranë. Me një diferencë mjaft të madhe nga Tirana, peshën më të madhe e zë **Bashkia Durrës me 5.6% dhe Bashkia Kamëz dhe Elbasan me 3.4%.**
- 11 bashkitë të cilat kanë popullsi mbi 100 mijë banorë, gjatë vitit 2022 kanë shpenzuar rreth **35.3 miliard lekë ose rreth 61%** të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor. Vetëm Bashkia Tiranë zë **48%** të totalit të shpenzimeve të këtyrë bashkive mbi 100 mijë banorë.
- Ky grup i bashkive kanë shpenzuar gjatë vitit 2022 rreth **6.6 miliard lekë shpenzime për investime ose rreth 56.8% të të gjithë shpenzimeve për investime të pushtetit vendor dhe 18.7% të shpenzimeve të realizuara nga këto bashki.**
- **13 bashkitë** me popullsi nga **50 mijë-100 mijë banorë** kanë realizuar rreth **9.5 miliard lekë ose vetëm 16% të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor.**
- Shpenzimet për investime për këto 13 bashki janë **1.8 miliard lekë ose 18.9% të të gjitha shpenzimeve të këtij grupi të bashkive dhe vetëm 15.5%** të totalit të shpenzimeve për investime të pushtetit vendor.
- Nga ana tjetër, shpenzimet e personelit në këtë grup të bashkive **janë rreth 4.6 miliard lekë ose 48.4% të totalit të shpenzimeve të tyre dhe vetëm 18.4% të totalit të shpenzimeve të personelit të pushtetit vendor.**
- 37 bashkitë me një popullsi nën 50 mijë banorë kanë realizuar gjatë vitit 2022 **rreth 13.1 miliard lekë shpenzime ose rreth 23% të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor.**
- Këto 37 bashki kanë realizuar shpenzime për investime rreth **3.1 miliard lekë vetëm 26.7% të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor.**

- Gjatë vitit 2022, këto bashki kanë realizuar rreth **6.5 miliard lekë shpenzime personeli ose rreth 49.6% të totalit** të buxhetit të tyre dhe rreth 26% të totalit të shpenzimeve të personelit të pushtetit vendor.
- Pushtetit vendor ka shpenzuar mesatarisht **rreth 17,431 lekë për banor**, nga të cilat rreth **3,791 lekë ose vetëm 21.7%** të buxhetit për banor janë përdorur **për investime**.
- Shpenzimet e personelit për banorë **rreth 8,550 lekë ose 49% të buxhetit** për banor dhe kategoria e shpenzimeve operative dhe të tjera me **rreth 5,090 lekë ose 29.3%** të buxhetit për banor.
- Bashkia Himarë ka nivelin më të lartë të **shpenzimeve totale për banor në rreth 40,385 lekë**, dhe nivelin më të ulët të shpenzimeve për banor e ka **bashkia Kurbin me vetëm 9,081 lekë**.
- Il bashkitë me numrin më të madh të popullsisë mbi **100 mijë banorë shpenzojnë mesatarisht rreth 15,245 lekë/banor**, **13 bashkitë e tjera me një popullsi ndërmjet 100 mijë-50 mijë banorë shpenzojnë mesatarisht 14,861 mijë lekë/banor**, ndërkohë pjesa tjetër e **37 bashkive të vogla me nën 50 mijë banorë shpenzojnë më shumë se të dy kategoritë më lart me mesatarisht 18,985 lekë/banor**.
- Bashkia Shkodër është ajo që ka vlerën më të ulët të **shpenzimeve të personelit për banor me rreth 4,175 lekë dhe pas saj bashkia Kurbin me rreth 5,026 lekë** për banor.
- Bashki me një numër relativisht të vogël popullsie, kanë shpenzime për banor mjaft të larta të tilla si **Skrapari me 16,117 lekë për banor**, **Fushë-Arrëzi 15,652 lekë për banor apo Puka e Pusteci me përkatësisht 14,609 dhe 13,359 lekë për banor**.



**Hyrje në raportin e
treguesve fiskalë vendorë
2022**

Pushteti vendor gjatë vitit 2022 ka bërë progres të dukshëm si në konsolidimin e menaxhimit financiar por gjithashtu përmirësimin e cilësisë së shërbimeve në nivel vendor. Analiza e treguesve financiarë të vitit 2022 dhe krahasimi me ecurinë në vite paraqet një pamje shumë dimensionale të të gjithë komponentëve të menaxhimit financiar në nivel vendor dhe sipas njësive të vetëqeverisjes vendore. Fokusi i këtij raporti do të jetë vlerësimi i kapacitetit fiskal të pushtetit vendor, cilësia e planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve apo problematikat e tjera si detyrimet e prapambetura apo fondet e trashëguara, të cilat kanë një rol të rëndësishëm në qëndrueshmërinë financiare. Ministria e Financave dhe Ekonomisë nën mbështetjen e projektit “Financat Lokale” në këtë raport paraqet rezultatet zyrtare dhe analizën e prirjeve të treguesve financiarë të pushtetit vendor për vitin 2022.

Reformat e zhvilluara në vite për modernizimin e financave vendore, kanë dhënë rezultate në përmirësimin e cilësisë së treguesve fiskalë, por nga ana tjetër edhe problematika të cilat ky raport i identifikon qartë. Gjatë vitit 2022, pushteti vendor ka treguar aftësi të mira për konsolidimin financiar dhe përmirësimin metodologjik të hartimit, zbatimit dhe monitorimit të buxhetit vendor. Rikthimi i rritjes ekonomike pas problemeve të shkaktuara nga tërmeti dhe pandemia, ndikoi në përmirësimin e situatës financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore. Evidentimi i problematikave të hasura në menaxhimin financiar gjatë vitit 2022 dhe formulimi i rekomandimeve për zgjidhje gjatë vitit 2023 do të jenë një fokus i rëndësishëm i kësaj analize.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë në mbështetje të strategjisë kombëtare të decentralizimit dhe në zbatim të parimeve të Kartës Europiane të Autonomisë Vendore ka punuar për të forcuar rolin financiar të pushtetit vendor, duke konsoliduar cilësinë e administrimit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore. Në këtë drejtim, tashmë pas 6 viteve nga miratimi i kuadrit ligjor për menaxhimin financiar në nivel vendor, do të analizojmë ecurinë në nivel vendor të reformave fiskale por edhe gjendjen financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore. Nga analiza e treguesve financiarë të pushtetit vendor gjatë vitit 2022, janë evidentuar disa *nga arritjet* dhe *problematikat kryesore* si më poshtë:

- a. Rritja e cilësisë së menaxhimit financiar nëpërmjet implementimit me sukses nga të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore të procedurave të hartimit të PBA-së, zbatimit të buxhetit dhe standardeve të monitorimit të realizimit të buxhetit vendor.
- b. Rritja e mbështetjes së dhënë nga buxheti qendror për pushtetin vendor në formën e transfertave (transferta e pakushtëzuar dhe sektoriale).
- c. Ruajtja e qëndrueshmërisë së transfertës së pakushtëzuar pavarësisht problemeve të shkaktuara si pasojë e pandemisë COVID-19, tërmetit, krizës ekonomike e energjitike.
- d. Përmirësimi i menaxhimit të financave vendore nëpërmjet përmirësimit të performacës së realizimit të të ardhurave të veta.

- e. Shpërndarja e Tatimit mbi të Ardhurat Personale duke i dhënë mundësi financiare shtesë njësive të vetëqeverisjes vendore për të amortizuar vështirësitë dhe rritur efektshmërinë e shërbimeve.
- f. Reforma e iniciuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në taksën e pasurisë është pasqyruar në rritjen e të ardhurave të pushtetit vendor nga kjo taksë.
- g. Konsolidimi i procedurave dhe sistemi i menaxhimit të financave vendore në të gjithë etapat, që nga hartimi i programit buxhetor afatmesëm tek zbatimi dhe monitorimi i tij; harmonizimi dhe unifikimi i procedurave për hartimin, zbatimin, raportimin, monitorimin e buxheteve të njësive të vetëqeverisjes vendore, në përputhje me standardet ndërkombëtare;
- h. Zbatimi i metodologjisë për hartimin e programit buxhetor afatmesëm në nivel produkti buxhetor, përmes formateve të reja;
- i. Prezantimi dhe përdorimi i treguesve të performancës në PBA dhe ndikimi pozitiv në rritjen e cilësisë së monitorimit të zbatimit të buxhetit vendor;
- j. Ulja e numrit të programeve buxhetore (nga 36 programe në 20 programe buxhetore) dhe fillimi i një faze të re pilotimi për hartimin e Programit Buxhetor Afatmesëm në tre bashki.
- k. Monitorimi i vazhdueshëm i treguesve fiskalë të zbatimit të buxhetit, në funksion të zbatimit të politikave buxhetore që do të rrisin efikasitetin dhe efektshmërinë e përdorimit të fondeve publike në nivel vendor;
- l. Përgatitja dhe publikimi periodik dhe vjetor i raportit të analizës së financave publike vendore;
- m. Hartimi i raporteve periodike të menaxhimit të vështirësive financiare, si një detyrim ligjor për të monitoruar situatën financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore; publikimi i raportit vjetor: "Mbi statusin e vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore";
- n. Asistenca e drejtpërdrejtë ndaj njësive të vetëqeverisjes vendore, në të gjitha hapat e menaxhimit financiar në nivel vendor përmes komenteve dhe konsultimit jo vetëm të hartimit të programit buxhetor afatmesëm, por edhe të raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit;
- o. Realizimi i trajnimeve, takimeve dhe konsultimeve të vazhdueshme me njësitë e vetëqeverisjes vendore në kuadër të masave të marra nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë për menaxhimin financiar në nivel vendor, si një hap parapërgatitor për zbatimin e sistemit AFMIS në nivel vendor në një periudhë afatmesme.
- p. Detyrimet e prapambetura vazhdojnë të jenë problem edhe për vitin 2022. Gjatë vitit 2022, janë realizuar vlerësime dhe raportime periodike mbi ecurinë financiare të detyrimeve të prapambetura të njësive të vetëqeverisjes vendore. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka përgatitur dhe publikuar raportin e gjendjes financiare për të 61 bashkitë, ku ka rezultuar se dhjetë bashki janë me probleme financiare dhe shtatë bashki me vështirësi

financiare. Për këto bashki është hartuar një plan rehabilitimi për daljen nga situata e problemeve/vështirësisë financiare i cili do të vijojë të zbatohet edhe në buxhetin e vitit 2023. Mbështetur mbi treguesit fiskalë janë dhënë gjithashtu rekomandime ndaj njësive të cilat kanë një ecuri jo pozitive në drejtim të rritjes së stokut të detyrimeve ndaj të tretëve. Ky proces monitorimi do të vazhdojë periodikisht edhe në vitin 2023, duke zbatuar me përpikmëri detyrimet ligjore dhe nënligjore mbi statusin e vështirësive financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore.

- q. Niveli i lartë i fondeve të papërdorura në një vit buxhetor dhe trashëgimi i tyre në buxhetin e vitit pasardhës, është një tjetër problematikë e evidentuara gjatë vitit 2022.

Të gjitha arritjet e mësipërme në drejtim të qeverisjes vendore, janë një tregues i rëndësishëm për rritjen e autonomisë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe për rrjedhojë rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara për qytetarët. Përballimi i një sfide të madhe ekonomike dhe buxhetore nga njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë vitit 2022, është një tregues pozitiv i punës së zhvilluar në këto vite në drejtim të stabilitetit makroekonomik, parashikueshmërisë së fondeve dhe transparencës së përdorimit me disiplinë të fondeve buxhetore.



**Treguesit fiskalë të
pushtetit vendor 2022**

Ministria e Financave dhe Ekonomisë në vitin 2022 ka ndjekur me përparësi jo vetëm ecurinë e hartimit të programit buxhetor afatmesëm/hartimin e raporteve periodike të monitorimit të buxhetit/procesin e zbatimit të buxhetit, por gjithashtu edhe realizimin e të ardhurave të veta vendore apo shpenzimeve në nivelin e njësive të vetëqeverisjes vendore. Përmes ndjekjes së ecurisë së treguesve fiskalë është siguruar ruajtja e qendrueshmërisë financiare por edhe monitorimi i mbulimit me fondet e nevojshme financiare të funksioneve të përcaktuara me ligj. Analiza e treguesve fiskalë të pushtetit vendor do të shërbejë si një formë jo vetëm për paraqitjen zyrtare të të dhënave por edhe për të treguar nëse janë përmbushur objektivat e qeverisë në raport me decentralizimin dhe mirëqeverisjen.

Ecuria e treguesve fiskalë të pushtetit vendor gjatë vitit 2022, ka rezultuar pozitive si në mbledhjen e të ardhurave ashtu edhe në ecurinë e realizimit të shpenzimeve për financimin e funksioneve të përcaktuara me ligj. Në këtë drejtim, pushteti vendor ka siguruar të ardhura të veta rreth **30.9 miliard lekë nga të cilat rreth 27.6 miliard lekë ose 89.2% e zënë të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore dhe pjesa tjetër prej 3.3 miliard lekë ose 10.8% janë të ardhurat jotatimore të pushtetit vendor**. Pushteti vendor gjatë vitit 2022 ka konsoliduar trendin e rritjes së të ardhurave të veta **me rreth 1.4 miliard lekë ose rreth 5% më shumë se një vit më parë**. Forcimi i kapacitetit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore është një objektivi rëndësishëm i realizuar në kuadër të krijimit të njësive vendore të forta financiarisht. Të ardhurat e pushtetit vendor nga taksat dhe tarifat vendore në vitin 2022, në raport me planin e të ardhurave të veta vendore të parashikuara në treguesit fiskalë janë realizuar rreth 100%. Pushteti vendor kishte planifikuar rreth 27.6 miliard lekë të ardhura nga taksat dhe tarifat, të ardhura të cilat janë realizuar plotësisht.

Tabela 1: Treguesit fiskal të realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve vendore

(në milion lekë)

Nr.	E M E R T I M I	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Ndryshimi i 2022 kundrejt 2021	Struktura
						Të Ardh. & Shpenz. ndaj Totalit 2022
I	Të Ardhurat e Qeverisjes Vendore	51,645	58,812	60,787	3.4%	100.0%
I.1	Të ardhurat e veta vendore	24,205	29,498	30,969	5.0%	50.9%
1	Taksa e Pasurisë	5,124	6,116	6,138	0.4%	19.8%
a.	Taksa mbi Ndërtesën	3,804	4,581	4,506	-1.6%	14.5%
b.	Taksa mbi tokën Bujqësore	544	584	583	-0.2%	1.9%
c.	Taksa mbi truallin	208	247	249	0.8%	0.8%
d.	Taksa mbi transaksionet e kryera me pasuritë e paluajtshme	568	704	800	13.7%	2.6%
2	Taksa vendore mbi veprimtarinë ekonomike të Biznesit të vogël	384	385	72	-81.3%	0.2%
3	Të ardhura jotatimore	2,246	2,852	3,331	16.8%	10.8%
4	Tarifa vendore	4,497	5,212	5,741	10.1%	18.5%
a.	Tarife vendore për zënie dhe hapësirave	569	737	866	17.5%	2.8%
b.	Tarifa pastrimi dhe higjienë	3,731	4,241	4,617	8.8%	14.9%
c.	Tarifa e gjelbërimit	197	234	258	10.5%	0.8%


Nr.	E M E R T I M I	Fakt 2020	Fakt 2021	Fakt 2022	Ndryshimi i 2022 kundrejt 2021	Struktura
						Të Ardh. & Shpenz. ndaj Totalit 2022
5	Taksa të tjera Vendore	11,955	14,934	15,687	5.0%	50.7%
a.	Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja	7,936.3	9,476.4	10,142.9	7.0%	32.8%
b.	Taksa e fjetjes ne hotel	94.7	186.4	290.5	55.8%	0.9%
c.	Taksa e tabelës	306.5	331.0	361.9	9.3%	1.2%
d.	Takse vendore e perkohshme	721.1	895.4	887.0	-0.9%	2.9%
e.	Taksa te tjera	2,896.3	4,044.6	4,004.8	-1.0%	12.9%
I.2	Grante	27,440	29,314	29,818	1.7%	49.1%
a.	Transferta e pakushtezuar	18,270	18,480	18,733	1.4%	62.8%
b.	Transferta e pakushtezuar sektoriale	7,840	9,309	9,353	0.5%	31.4%
b.	Grante te huaja	530	555	692	24.7%	2.3%
c.	Grante te tjera te brendshme	800	970	1040	7.2%	3.5%
II	Shpenzime te Qeverisjes Vendore	51,627	52,584	58,693	11.6%	
1	Shpenzime Korrente	38,716	41,302	46,780	13.3%	79.7%
a.	Paga personeli	19,195	20,703	21,615	4.4%	36.8%
b.	Kontributi për Sigurime Shoqërore	3,196	3,416	3,596	5.3%	6.1%
d.	Shpenzime Operative	15,169	15,701	18,749	19.4%	31.9%
e.	Shpenzime financiare	1,156	1,482	2,823	90.5%	4.8%
2	Shpenzime Kapitale	12,911	11,282	11,913	5.6%	20.3%

Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Një tjetër burim i rëndësishëm i financimit të pushtetit vendor janë transfertat e buxhetit qendror të përfituara përmes ligjit vjetor të buxhetit 2022. Në vitin 2022, pushteti vendor ka përfiturar në formën e **transfertave rreth 29.8 miliard lekë ose rreth 1.7% më shumë se një vit më parë**. Sipas natyrës së transfertës **rreth 62.8% ose 18.7 miliard lekë pushteti vendor e merr në formën e transfertës së pakushtezuar e cila shpërndahet sipas formulës së përcaktuar me ligj**. Një peshë tjetër të rëndësishme në transfertat e buxhetit qendror e zënë transfertat e pakushtëzuara sektoriale me rreth **9.3 miliard ose rreth 31.4% të totalit të transfertave**. Pjesa tjetër e transfertave në formën e granteve pushteti vendor i merr nga **financimi i huaj në rreth 692 milion lekë ose 2.3% të totalit të transfertave dhe burime të tjera si taksat e ndara në vlerën e rreth 3.5% ose rreth 1 miliard lekë**.

Një ecuri mjaft pozitive gjatë vitit 2022 ka patur edhe realizimi i shpenzimeve të pushtetit vendor. **Nga 61.4 miliard lekë shpenzime të planifikuara për pushtetin vendor në treguesit fiskalë të buxhetit, janë realizuar rreth 95% ose në vlerë absolute rreth 58.6 miliard lekë**. Rritja e cilësisë së menaxhimit financiar në nivel vendor është reflektuar në **rritjen e shpenzimeve vendore krahasuar me një vit më parë me rreth 6.1 miliard lekë ose 11.6% më shumë shpenzime vendore**. Rritja e buxhetit vendor është një siguri më shumë për ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj qytetarëve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Grafiku 1: Krahasimi i planit dhe realizimit faktik vjetor 2022 të të ardhurave dhe shpenzimeve sipas treguesve fiskal.




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Pushteti vendor ka akumuluar çdo muaj të ardhura dhe shpezime sipas grafikut të mëposhtëm. Ashtu siç mund të evidentohet qartë të ardhurat vendore kanë një shpërndarje ciklike 4 mujore, në të cilën pushteti vendor siguron pjesën më të madhe të të ardhurave nga burimet e veta. Ndërkohë që shpenzimet vendore kanë ruajtur një trend të qëndrueshëm mujor, **vetëm në 2 muajt e fundit konstatohet një kapercim jo normal i trendit të shpenzimeve me rreth 15.4 miliard lekë shpenzime ose 26% të totalit të shpenzimeve që pushteti vendor ka realizuar gjatë gjithë vitit.** Ruajtja e trendit të ciklit 3 apo 6 muajor të realizimit të të ardhurave të veta vendore do ti shërbejë uljes së riskut të pushtetit vendor në menaxhimin financiar publik.

Në kuadër të mirëmenaxhimit financiar në nivel vendor, me qëllim shmangien e fenomenit të realizimit shumë të lartë të shpenzimeve në fund të vitit, kryesisht shpenzimeve të cilat lidhen vetëm me likuidimin e investimeve, është i nevojshëm rekomandimi për respektimin e planit të detajuar mujor të shpenzimeve dhe përmes disiplinimit të sigurohet shmangia e mundësisë për krijimin e detyrimeve të prapambetura. Ndryshimet e shpeshta të këtij plani gjatë vitit janë tregues i qartë i riskut potencial që ka menaxhimi financiar i atyre njësive të vetëqeverisjes vendore.

Grafiku 2: Trendi i të ardhurave dhe shpenzimeve diskrete mujore të pushtetit vendor gjatë vitit 2022




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Analiza e treguesve fiskal të pushtetit vendor gjatë vitit 2022, krahasuar me realizimin para reformës adminstrativo-territoriale paraqet një informacion të rëndësishëm mbi cilësinë e menaxhimit financiar. Pushteti vendor në këto 7 vite, si në grafikun e mëposhtëm, **realizon rreth 24.6 miliard lekë ose 72.3% më shumë shpenzime për financimin e funksioneve të përcaktuara në ligj.**

Një tjetër aspekt është rritja e kapacitetit fiskal në mbledhjen e të ardhurave të veta vendore, nga 11.7 miliard lekë që pushteti vendor siguronte nga taskat dhe tarifatat vendore në vitin 2015 arriti vlerën e rreth 27.6 miliard lekë në vitin 2022. Në këtë drejtim, **pushteti vendor siguron rreth 16.2 miliard lekë ose 138% më shumë të ardhura nga taksat dhe tarifatat vendore**. Reforma administrativo-territoriale përmirësoj ndjeshëm kapacitetin fiskal të pushtetit vendor, duke konsoliduar në këtë mënyrë aftësinë për rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve.


Grafiku 3: Krahasimi i të ardhurave nga taksat vendore dhe shpenzimeve të pushtetit vendor 2015/2022



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Rritja e të ardhurave nga burime të ndryshme dhe konsolidimi i shpenzimeve të pushtetit vendor është reflektuar në grafikun e mëposhtëm. Pushteti vendor ka përfituar gjatë vitit 2022 rreth **28 miliard lekë transfertë të pakushtëzuar dhe sektoriale ose ndryshe rreth pothuajse 48% të totalit të shpenzimeve vendore**. Një tregues pozitiv është norma e rritjes së të ardhurave të veta vendore me rreth 5 miliard lekë më shumë se një vit më parë, ndërkohë që transfertat janë rritur me vetem 2.7 miliard lekë. Në këtë drejtim, ndryshimi i këtij raporti mes të ardhurave të veta vendore apo transfertat e pakushtëzuar e ajo sektoriale, është një tregues pozitiv që pushteti vendor po thellon autonominë fiskale.

Grafiku 4: Financimi i pushtetit vendor në vite sipas burimit të të ardhurave.




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

2.1 Të ardhurat e pushtetit vendor

Rritja e të ardhurave të veta vendore në kuadër të konsolidimit të ecurisë së decentralizimit por gjithashtu ruajtja e qendrueshmërisë së transfertave të buxhetit qendror në vitin 2022 krijoi kushtet e favorshme për një pjesë të konsiderueshme të njësive të vetëqeverisjes vendore për të nxitur politika të reja në drejtim të cilësisë së shërbimeve publike. Duke marrë në konsideratë rëndësinë që kanë burimet e financimit të pushtetit vendor, për përmirësimin e jetës së qytetarëve, në këtë seksion janë analizuar të gjitha burimet kryesore të të ardhurave të njësive të vetëqeverisjes vendore.

Në vitin 2022, pushteti vendor ka mbledhur nga taksat dhe tarifat vendore **rreth 27.6 miliard lekë dhe të ardhura joutatimore rreth 3.3 miliard lekë ose në total rreth 31 miliard lekë të ardhura të veta**. Pavarësisht se trendi i rritjes gjatë vitit 2022, ka qënë me i ulët se një vit më parë, të ardhurat vendore kanë pësuar **një rritje prej 9% ose 2.2 miliard lekë më shumë**. Pushteti vendor ka konsoliduar në këtë mënyrë ecurinë pozitive të rritjes së burimeve të veta të financimit të shërbimeve që ofron për komunitetin. Ky trend pozitiv referuar treguesve fiskalë të buxhetit të shtetit pritet të ruhet nga pushteti vendor edhe gjatë vitit 2023.

Grafiku 5: Të ardhurat nga taksat dhe tarifat vendore dhe ecuria e ndryshimit në vite




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Një aspekt i rëndësishëm i menaxhimit financiar në nivel vendor është krahasimi i të ardhurave të veta vendore me të ardhurat publike dhe produktin e brendshëm bruto. Si në grafikun e mëposhtëm, gjatë vitit 2022 të ardhurat vendore janë rreth 4.54% të të ardhurave publike dhe rreth 1.34% të produktit të brendshëm bruto. Krahasuar me trendin e një viti më parë, pavarësisht rritjes

në vlerë absolute të të ardhurave të veta vendore, në raport me të ardhurat publike ato kanë rënë me rreth 0.25%. Ndaj produktit të brendshëm bruto të ardhurat në vitin 2022, janë pothuajse në të njëjtin nivel me vitin 2022.

Ndryshimet e inflacionit të cilat afektuan rritjen ndjeshëm të të ardhurave publike (kryesisht të ardhurat nga tatimi mbi konsumin) dhe produktin e brendshëm bruto, nuk janë reflektuar në të njëjtën masë tek pushteti vendor. Detyrimet fiskale të pushtetit vendor janë të një natyre që nuk lidhen direkt me inflacionin. Kjo tregon dhe një herë burime të pa diversifikuara mirë të të ardhurave të veta vendore, të cilat në këto raste nuk kanë ndjekur trendin kombëtar të ecurisë së të ardhurave publike dhe produktit të brendshëm bruto.


Grafiku 6: Të ardhurat e veta vendore ndaj të ardhurave publike dhe PBB-së në vite



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Pushteti vendor gjatë vitit 2022, vetëm **10.6% ose 3.3 miliard lekë ka akumuluar nga të ardhurat jotatimore**, ndërkohë që pjesa tjetër e konsiderueshme ose 27.6 miliard lekë janë të ardhurat tatimore. Krahasuar me një vit më parë, të dy këto burime kanë ndjekur një trend rritës, ku të ardhurat jotatimore janë rritur me rreth 16.8% dhe të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore janë rritur me rreth 1 miliard lekë ose 3.7%.


Grafiku 7: Të ardhurat tatimore dhe jotatimore të pushtetit vendor në vitin 2021 dhe 2022



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore janë mbështetur në të ardhurat nga taksat e tarifatat vendore dhe një peshë mjaft të vogël kanë të ardhurat jotatimore. Duke ju referuar grafikut të mëposhtëm, bashkitë e vogla si Hasi, Rogozhina apo Vora kanë një raport të të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore me mbi 95% të totalit të të ardhurave të veta. Nga ana tjetër, një peshë të konsiderueshme kanë të ardhurat e veta jotatimore në bashki të tilla si Kurbin dhe Memaliaj, përkatësisht 43% dhe 57%.


Grafiku 8: Pesha sipas natyrës së të ardhurave në vitin 2022, sipas bashkive.



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Taksa e ndikimit në infrastrukturë në nivel agregat vazhdon të mbetet një ndër burimet më të rëndësishme të financimit të pushtetit vendor në vitin 2021 dhe vitin 2022. Në raport me një vit më parë ky burim është rritur me rreth rreth 7% gjatë vitit 2022. Burimi tjetër që zë peshën më të madhe është taksa mbi ndërtesën, e cila në raport me një vit më parë ka patur një rënie të lehtë me rreth 2%. Burime të tjera për pushtetin vendor janë tarifatat e pastrimit dhe higjienës dhe të ardhurat jotatimore.

Grafiku 9: Të ardhurat e veta vendore të pushtetit vendor sipas burimit gjatë vitit 2022/2021




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Burimi me peshën më të madhe në të ardhurat vendore gjatë vitit 2022, është taksa e ndikimit në infrastrukturë me rreth 33% të të ardhurave të veta vendore. Pavarësisht se në nivel agregat ky burim është më i rëndësishmi për pushtetin vendor, në nivel njësie rreth 72.9% e mbledh vetëm Bashkia Tiranë. Në këtë drejtim evidentohet qartë roli i madh që po mban për bashkinë Tiranë ky burim i cili nuk siguron qëndrueshmëri financiare në kohë. Por nga ana tjetër, është një burim potencial në të ardhmen për të ardhura nga taksa mbi ndërtesën.

Taksa mbi ndërtesën dhe tarifa mbi pastrimin e higjenën zënë përkatësisht secila nga 15% të të ardhurave të veta vendore. Rritja e burimeve financiare të cilat sigurojnë qëndrueshmëri në financimin e shërbimeve vendore, do të jetë në fokusin e reformave që do të ndërmarrë Ministria e Financave dhe Ekonomisë në drejtim të të ardhurave vendore.


Grafiku 10: Peshat e të ardhurave të veta vendore sipas burimit gjatë vitit 2022/2021



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Në grafikun pasardhës janë paraqitur peshat e të ardhurave të veta sipas grupit të burimeve më të rëndësishme në nivelin e njësive të vetëqeverisjes vendore. Pothuajse në të gjitha bashkitë, grupi i taksave lokale zënë peshën më të madhe të të ardhurave dhe pas tij burimi më i rëndësishëm janë të ardhurat nga grupi i taksave mbi pasurinë. Në këtë konstatim, përjashtim bëjnë bashkia Roskovec dhe bashkia Patos tek të cilat taksat mbi pronën kanë peshën dominuese në 53.9% dhe 55.7%.


Grafiku 11: Pesha e të ardhurave sipas bashkive dhe burimit për vitin 2022



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Në vlerë absolute, pushteti vendor në të gjitha burimet financiare ka patur një rritje të qëndrueshme, mes të cilave ndikimin më të madh e ka patur e ardhura nga taksa e ndikimit në infrastrukturë në rreth 10 miliard lekë ose rreth 1/3 e totalit të të ardhurave të veta vendore. Një rol të rëndësishëm për pushtetin vendor luajnë edhe të ardhurat nga tarifa të ndryshme që mbliidhen për shërbime të dhëna drejtpërdrejt qytetarëve. Rritja e volumit të të ardhurave nga tarifat, është tregues i rritjes së kërkesës për shërbime publike nga qytetarët por gjithashtu edhe të kapacitetit në rritje të pushtetit vendor për ti ofruar ato.


Grafiku 12: Të ardhurat e veta vendore në vite sipas burimit



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Nëse në analizë do të marrim krahasimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, në dy vitet e fundit këto burime kanë ruajtur një trend të përafërt të të ardhurave për pushtetin vendor. Rreth 29% të totalit të të ardhurave të veta vendore ose 9 miliard lekë i ka mbledhur nga tarifave vendore, ndërkohë pjesa tjetër prej 71% janë nga taksat vendore. Nëse krahasojmë më një vit më parë, është rritur pesha e të ardhurave nga tarifave vendore me 2% ose 1.2 miliard lekë nga 27% që ishte në vitin 2021. Rritja e të ardhurave nga taksat vendore ka qëndruar në të njëjtat nivele me një vit më parë.


Grafiku 13: Të ardhurat e grupuara në nivelin e taksave dhe tarifave vendore 2022 dhe 2021.



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Një ndër burimet më të rëndësishme si në këndvështrimin e peshës që ato zënë në totalin e të ardhurave të veta vendore, por gjithashtu edhe të qëndrueshmërisë që kanë si burim financimi janë të ardhurat nga taksat mbi pasurinë e paluajtshme. Gjatë vitit 2022, pushteti vendor nga tatimi mbi pasurinë ka akumuluar rreth 6.1 miliard lekë, të njëjtin nivel të të ardhurave krahasuar me një vit më parë. Ashtu si në grafikun e mëposhtëm, taksat mbi pasurinë janë në një trend normal rritje ndër vite. Gjithashtu, në raport me planin vjetor të treguesve fiskalë të këtij burimi, konstatohet një realizim në masën 99% të të ardhurave nga ky burim.


Grafiku 14: Të ardhurat nga taksa e pasurisë së paluajtshme në vite



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Taksa mbi ndërtesën është burimi kryesor në këtë grupim nga taksat mbi pasurinë, pas tij vinë të ardhurat nga transaksioni i pasurive, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksat mbi truallin. Mungesa e implementimit të kadastrës fiskale dhe problematikave të hasura me metodologjinë e re ka bërë që të ardhurat nga taksa mbi ndërtesën të pësojnë një rënie mjaft të lehtë në krahasim më një vit më parë në masën e 80 milion lekë. Taksimi i pronës mbetet një sfidë e rëndësishme për konsolidimin fiskal të njëjësive të vetëqeverisjes vendore.


Grafiku 15: Të ardhurat nga taksat e pasurisë sipas burimit në vitin 2022 dhe 2021



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Taksa mbi ndërtesën zë rreth 73% të totalit të të ardhurave nga taksat mbi pasurinë, peshë kjo mjaft e rëndësishme për të treguar rolin që ka në kapacitetin fiskal të njëjësive të vetëqeverisjes vendore. Krahasuar më një vit më parë, ka një rënie të peshës që zë ky burim ndërkohë që janë rritur të ardhurat nga transaksioni i pasurive të paluajtshme me rreth 2% më shumë. Rritja e tregut imobiliar është reflektuar në këtë mënyrë në të ardhura shtesë për pushtetin vendor.


Grafiku 16: Taksat mbi pasurinë sipas peshave gjatë vitit 2022 dhe 2021



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Në nivel bashkie si në grafikun pasardhës janë paraqitur të ardhurat nga taksa e pasurisë gjatë vitit 2022. Peshën më të madhe në të gjitha bashkitë e dominon Taksa mbi Ndërtesën me përjashtim të dy bashkive si Memaliaj dhe Devoll, ku pjesën më të madhe e zë taksa e tokës bujqësore. Ndërkohë në bashki të tjera si Kurbin dhe Mat, taksa mbi ndërtesën zë konsiderueshëm pjesën më të madhe të të ardhurave nga taksat mbi pasurinë me përkatësisht 94% dhe 95% të të ardhurave.


Grafiku 17: Përbërja e të ardhurave nga taksat mbi pasurinë për vitin 2022, sipas bashkive



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Sipas grafikut të mëposhtëm burimi më i rëndësishëm me rreth 10 miliard lekë janë të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe më pas burimi më i rëndësishëm janë të ardhurat nga tarifa e pastrimit e gjelbërimit me rreth 4.6 miliard lekë. Ashtu siç mund të konstatohet në grafikun më poshtë pothuajse të gjitha burimet e të ardhurave vendore kanë pësuar një rritje të lehtë krahasuar me vitin 2021.


Grafiku 18: Taksat e tjera vendore sipas vlerave gjatë vitit 2022 dhe 2021



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Referuar peshës së zërave, peshën më të madhe e zë taksa e ndikimit në infrastrukturë me rreth 47% të totalit të të ardhurave. Dhe më pas, burimi më i rëndësishëm janë tarifa e pastrimit dhe higjenes me 22% të totalit të këtij grupi të të ardhurave vendore. Ajo që konstatohet në këtë grup të të ardhurave është fakti që krahasuar më një vit më parë, gjatë vitit 2022 pushteti vendor ka ruajtur të njëjtën peshë të të ardhurave sipas burimeve.


Grafiku 19: Taksat e tjera vendore sipas peshave gjatë vitit 2022 dhe 2021



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Pas zerimit të tatim fitimit mbi biznesin e vogël, pushteti vendor në vite ka akumuluar gjithnjë dhe më pak të ardhura nga ky burim. Në vitin 2022, të ardhurat nga ky burim të cilat lidhen vetëm me detyrimet e prapambetura të bizneseve janë 72 milion lekë, vlerë kjo shumë e vogël krahasuar me vitin 2010 periudhë kjo në të cilën pushteti vendor siguronte rreth 2.5 miliard lekë.


Grafiku 20: Të ardhurat nga tatim fitimi mbi biznesin e vogël



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Pushteti vendor ofron disa shërbime koston e të cilave e mbulon përmes tarifave të mbledhura nga qytetarët përfitues. Gjatë vitit 2022 nga tarifatat e shërbimeve vendore janë akumuluar rreth 9 miliard lekë ose thënë ndryshe rreth 1.3 miliard lekë më shumë se një vit më parë. Rritja e të ardhurave nga këto shërbime janë tregues i qartë i numrit në rritje të qytetarëve që përfitojnë nga shërbimet vendore. Krahasuar me vitin 2010, pushteti vendor në vitin 2022 ka akumuluar nga tarifatat vendore 7.8 miliard lekë më shumë të ardhura.


Grafiku 21: Të ardhurat nga tarifatat e shërbimeve vendore



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Taksa e ndikimit në infrastrukturë është kthyer për pushtetin vendor në vitet e fundit një ndër burimet më të rëndësishme të të ardhurave të veta vendore. Rritja progresive pas vitit 2015 shikohet qartë në grafikun e mëposhtëm. Pushteti vendor ka akumuluar rreth **10.1 miliard lekë nga ky burim ose 8.7 miliard lekë më shumë se të ardhurat e vitit 2015**. Kjo rritje nuk paraqet një tregues të qëndrueshëm zhvillimi standard në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, për sa kohë ashtu si e kemi evidentuar edhe më lart rreth 72.9% e totalit të të gjithë këtij burimi mbledhet vetëm nga Bashkia Tiranë.


Grafiku 22: Të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale përbën gjithashtu një burim të rëndësishëm për financimin e funksioneve të pushtetit vendor. Gjatë vitit 2022, pushteti vendor ka përfituar në total rreth 28 miliard lekë në formën e transfertave, nga të cilat rreth 18.7 miliard lekë ose 66.7% janë transferta të pakushtëzuara të përgjithshme të cilat shpërndahen përmes formulës dhe pjesa tjetër prej 9.3 miliard lekë ose 33.3% janë në formën e transfertës së pakushtëzuar sektoriale për financimin e funksioneve të transferuara në nivel vendor.

Grafiku 23: Transferta e Pakushtëzuar e pushtetit vendor në vite




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Në pjesën më të madhe të njësive të vetëqeverisjes vendore të ardhurat e veta vendore kanë rezultuar me rritje, por nga ana tjetër ekzistojnë edhe njësi në të cilat të ardhurat kanë pësuar rënie. Gjatë vitit 2022, **të ardhurat e veta vendore në 21 bashki ose 34.4% e tyre kanë rënie në raport me një vit më parë**, ndërkohë pjesa tjetër prej 40 bashkive kanë patur rritje të të ardhurave të veta.

Bashkitë me rënie më të madhe janë **bashkia Patos me rreth 47% ose 89 milion lekë më pak se në vitin 2021**. Më pas bashkitë **Këlcyrë dhe Selenicë kanë një rënie me rreth 30% dhe 24% ose rënie në vlerë absolute përkatësisht 4 milion lekë dhe 20 milion lekë**. Ndërkohë disa bashki të vogla me numër popullsie kanë patur një rritje eksponenciale të të ardhurave të veta vendore të tilla si Memaliaj dhe Skrapari me një rritje përkatësisht 124% dhe 48%.

Në vlerë absolute rritjen më të madhe për vitin 2022 e ka bashkia Tiranë me rreth **533 milion lekë më shumë krahasuar me vitin 2021**. Bashkitë tjera të cilat kanë një rritje të konsiderueshme në raport me vitin 2021 janë **bashkia Kamëz me rreth 250 milion lekë dhe bashkia Vlorë me rreth 230 milion lekë**. Rënie të konsiderueshme të të ardhurave të veta vendore në vlerë absolute kanë patur bashkia Durrës dhe bashkia Fier me përkatësisht 73 milion lekë dhe 45 milion lekë.

Grafiku 24: Ndryshimi i të ardhurave të veta vendore 2022/2021 sipas bashkive




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Një analizë e rëndësishme e të ardhurave vendore është krahasimi i peshës që secila bashki zë në totalin e kapacitetit fiskal të pushtetit vendor. Viti 2022, ka konsoliduar pozitën dominuese të bashkisë Tiranë në të ardhurat e pushtetit vendor. Bashkia Tiranë, ka mbledhur rreth 17.3 miliard lekë të ardhura të veta vendore ose rreth 56.1% të të ardhurave të pushtetit vendor. **Ndërkohë që i gjithë pushteti vendor ka siguruar nga burime të qëndrueshme të të ardhurave nga taksat mbi pasurinë rreth 6.1 miliard lekë, vetëm bashkia Tiranë nga këto burime ka siguruar 2.9 miliard lekë ose 47% të këtij burimi të të gjithë pushteti vendor.**

Të grupuara sipas numrit të popullsisë, **11 bashkitë me mbi 100 mijë banorë ose 18% e bashkive kanë akumuluar gjatë vitit 2022 rreth 24 miliard lekë ose ndryshe rreth 80% të totalit të të ardhurave të pushtetit vendor.** Bashkitë më një popullsi nga **50 mijë-100 mijë banorë, të cilat janë 13 bashki ose 21% e totalit të bashkive** kanë mbledhur vetëm 2.7 miliard lekë ose 8.7% të totalit të të ardhurave vendore.

Bashkitë me **nën 50 mijë banorë janë 37 ose 61 % e totalit të bashkive, ku gjatë vitit 2022 kanë mbledhur vetëm 3.4 miliard lekë ose 11.3%** të totalit të të ardhurave të pushtetit vendor. Nga këto tregues, evidentohet qartë që të ardhurat e veta vendore janë të pabalancuara në nivelin e njësisive të vetëqeverisjes vendore, duke sjellë në vëmendje nevojën për ndërhyrje me politika të reja të cilat do të ulnin këto diferenca në përputhje me kushtet specifike të tyre.

Grafiku 25: Pesha e të ardhurave sipas bashkive ndaj totalit të të ardhurave vendore 2022




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Bashkia Tiranë ashtu siç evidentohet në grafikun e mësipërm luan një rol të rëndësishëm në zhbancimin e treguesve të të ardhurave të pushtetit vendor. Duke përjashtuar këtë bashki nga të dhënat, konstatohet që pjesë të konsiderueshme të të ardhurave të pushtetit vendor e zë bashkia Vlorë me rreth 3.6%, bashkia Durrës me 4.2% dhe bashkia Kamëz me rreth 3.1%.

Në këtë grafik, konstatohet një shpërndarje normale e peshave që zënë të ardhurat e veta në raport me totalin e pushtetit vendor sipas bashkive duke mbajtur në konsideratë nivelin e zhvillimit ekonomik të tyre. Përmirësimi i kapacitetit fiskal vendor dhe krijimi i mekanizmave të rishpërndarjes së të ardhurave, për të shmangur thellimin e zhbancimit fiskal të pushtetit vendor, janë politika të rëndësishme të cilat duhen vlerësuar për tu implementuar në të ardhmen.

Grafiku 26: Pesha e të ardhurave sipas bashkive ndaj totalit të të ardhurave vendore 2022, pa përfshirë bashkinë Tiranë.




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

2.2 Shpenzimet e pushtetit vendor

Pushteti vendor gjatë vitit 2022 ka një rritje të shpenzimeve të cilat financohen nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar sektoriale dhe të përgjithshme, si dhe të ardhurat nga burimet e veta, me rreth 3% në raport me një vit më parë. Në vlerë absolute buxheti vendor ka realizuar 58.6 miliard lekë ose në vlerë absolute rreth 2 miliard lekë më shumë shpenzime krahasuar më vitin 2021. Konsolidimi i buxhetit vendor në një trend të qëndrueshëm rritje është një tregues i rëndësishëm i qëndrueshëmrisë financiare të njësisive të vetëqeverisjes vendore.

Grafiku 27: Shpenzimet e pushtetit vendor në vite dhe trendi i rritjes




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Trendi i rritjes së shpenzimeve vendore identifikohet qartë jo vetëm në vlerë absolute por gjithashtu edhe në raport me produktin e brendshëm bruto apo në tërësi shpenzimet publike. **Gjatë vitit 2022, pushteti vendor ka realizuar shpenzime sa 3.01% e Produktit të Brendshëm Bruto dhe gjithashtu sa 9.39% të shpenzimeve publike.** Trendi i rritjes së shpenzimeve ka vazhduar gjithashtu edhe në treguesit fiskalë të vitit 2022. Krahasuar me një vit më parë, gjatë vitit 2022 shpenzimet e **pushtetit vendor në raport me PBB kanë pësuar një rritje të lehtë prej 0.37%**. Nga ana tjetër, **në raport me shpenzimet publike të një viti më parë, shpenzimet e pushtetit vendor patën një rritje prej 0.43%** krahasuar me një vit më parë.

Ky raport është një ndër treguesit më të rëndësishëm që shpreh jo vetëm rolin e pushtetit vendor por gjithashtu edhe shkallën e decentralizimit fiskal të pushtetit vendor. Për të përmirësuar këto raporte duhen shtuar mekanizmat financiarë që sigurojnë garanci të shtuar edhe në rritjen e aftësisë së njësive të vetëqeverisjes vendore në ofrimin e shërbimeve publike.

Grafiku 28: Shpenzimet vendore në vite, në raport me shpenzimet publike dhe produktin e brendshëm bruto.




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Nga analiza e shpenzimeve vendore në nivel të llogarive ekonomike, konstatohet që peshë të konsiderueshme gjatë vitit 2022 e zënë shpenzimet për paga dhe sigurime me rreth **43% të totalit të shpenzimeve vendore**. Në raport me një vit më parë konstatohet që **shpenzimet për investime kanë një rritje me rreth 630 milion lekë**, ndërkohë që **shpenzimet e personelit kanë një rritje rreth 1.09 miliard lekë. Ajo që vihet re gjatë vitit 2022 janë** rritja e shpenzimeve operative **me rreth me 3 miliard lekë** krahasuar me shpenzimet e vitit 2021. Një faktor i rëndësishëm i kësaj rritje të koniderueshme të shpenzimeve operative ndryshe nga trendi i viteve të shkuara ka ardhur si pasojë e rritjes së kostove të veprimtarisë operacionale (rritja e **çmimit** të produkteve të cilat NJVQV-të kanë përdorur për funksionimin).

Në këtë drejtim pushteti vendor ka ndryshuar peshën e shpenzimeve sipas natyrës ekonomike në krahasim me një vit më parë. Është e rëndësishme të theksohet rritja e peshës së shpenzimeve për investime me rreth 5.6% ose 600 milion lekë më shumë se në vitin 2021.

Grafiku 29: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike të buxhetit vendor 2022/2021,




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Trendin më të rëndësishëm të ndryshimit të shpenzimeve gjatë vitit 2022 e kanë pësuar shpenzimet për investime, me rreth 1.2% më shumë se viti 2021.

Nga ana tjetër, shpenzimet operative janë rritur me rreth 2% dhe në të njëjtën masë gjithashtu edhe shpenzimet e tjera korrente krahasuar më peshën e vitit 2021. Si pasojë e rënies së peshës së shpenzimeve të investimeve dhe atyre të personelit pushteti vendor ka rritje të ndjeshme të pjesës tjetër të shpenzimeve.


Grafiku 30: Pesha e shpenzimeve sipas natyrës ekonomike të pushtetit vendor për vitet 2022/2021



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Në nivelin e njësive të vetëqeverisjes vendore, si në grafikun e mëposhtëm jepen peshat që zënë shpenzimet sipas llogarive ekonomike në totalin e shpenzimeve vendore. Në këtë drejtim konstatohet që njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë një trend të ngjashëm, ku pesha më e madhe janë shpenzimet e personelit dhe më pas ato për investime.


Grafiku 31: Pësja e shpenzimeve të njëjive të vetëqeverisjes vendore sipas llogarive ekonomike 2022



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Në analizën e shpenzimeve sipas funksioneve, gjatë vitit 2022, pushteti vendor ka financuar në pjesën më të madhe funksionin e **“Shërbimeve të përgjithshme publike”** dhe **“Arsimit”**, përkatësisht në masën **22% dhe 19%** të totalit të shpenzimeve vendore. Pësha e këtyre shpenzimeve të pushtetit vendor sipas funksioneve paraqet qartë rëndësinë që kanë këto shpenzime në raport me shërbimet publike që njësitë e vetëqeverisjes vendore ushtrojnë.

Grafiku 32: Pësha e shpenzimeve sipas natyrës funksioneve të pushtetit vendor për vitet 2022/2021



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);


Shpenzimet e pushtetit vendor, gjatë vitit 2022 kanë pësuar ndryshime në një masë mjaft të vogël krahasuar me një vit më parë, në disa prej funksioneve bazë.

Si rrjedhojë e përmirësimit të ecurisë së treguesve konstatohet se funksionet që kanë patur rritje të shpenzimeve gjatë vitit 2022 janë “05-Mbrojtja e mjedisit” me një rritje prej 2% dhe pothuasje të njëjtën përqindje rritje ka patur shpenzimet për funksionin “08-Argëtimi, Kultura dhe Feja”.

Ndërkohë, gjatë vitit 2022 funksionet me rënie më të madhe krahasuar me vitin 2021 e kanë pësuar ato të “01-Shërbimet e Përgjithshme Publike” dhe “09-Arsimi” me rreth 1%. Pjesa tjetër e funksioneve të pushtetit vendor kanë qëndruar në të njëjtën peshë të shpenzimeve. Siç konstatohet, riallokimi i fondeve e si rrjedhojë ndryshimi i peshave nga viti në vit ka ndodhur vetëm në funksionet kryesore që kanë pjesën më të rëndësishme të shërbimeve publike në nivel vendor.

Analiza krahasimore e ndryshimit në vite e shpenzimeve sipas funksioneve është një aspekt i rëndësishëm i evidentimit të prioriteteve që njësitë e vetëqeverisjes vendore ndryshojnë nga viti në vit në raport me shërbimet publike që ofrojnë.

Grafiku 33: Ndryshimi i shpenzimeve sipas funksioneve të pushtetit vendor 2022/2021




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Si në grafikun e mësipërm, gjatë vitit 2022 funksionet me rritjen më të rëndësishme pavarësisht peshës më të ulët që kanë në raport me funksionet e tjera, e kanë patur Shëndetësia dhe Mbrojtja e Mjedisit. Rritja në përqindje e këtyre funksioneve gjatë vitit 2022 është përkatësisht 75% dhe 40%.

Nga analiza e treguesve të vitit 2022, një aspekt i rëndësishëm i politikave vendore është edhe financimi i funksioneve ligjore sipas burimeve të të ardhurave, shpërndarje e cila evidentohet në grafikun e mëposhtëm. Vetëm funksioni “Shërbime të Përgjithshme Publike” financohet në rreth 1 miliard lekë më shumë nga transfertat e buxhetit qendror. Ky raport financimi për këtë funksion është i njëjtë me raportin e një viti më parë. Ndërkohë nga të ardhurat e veta pushteti vendor financon më shumë funksionet e “Çështjeve ekonomike”, “Mbrojtja e mjedisit” apo funksioni “Strehimi dhe komoditetet e komunitetit”.

Funksionet të cilat janë financuar kryesisht me transfertat që pushteti vendor merr nga ai qendror janë të tilla si “Shërbimet e Përgjithshme Publike”, “Rendi dhe siguria publike”, “Arsimi” dhe “Mbrojtja Sociale”.


Grafiku 34: Burimet e financimit të funksioneve vendore gjatë vitit 2022



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Gjatë vitit 2022, pothuajse 100% të njësive të vetëqeverisjes vendore peshën më të madhe të shpenzimeve e kanë përdorur për financimin e 2 funksioneve bazë siç është ai për “Shërbimet e përgjithshme publike” dhe “Arsimin”. Ruajtja e një trendi të ngjashëm të peshës së funksioneve si në bashkitë e mëdha financiarisht ashtu edhe në ato më të vogla, tregon rëndësinë që këto funksione kanë për shërbimet në nivel vendor.


Grafiku 35: Pesha e shpenzimeve sipas natyrës së funksioneve të pushtetit vendor në nivel bashkie në vitin 2022



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Në grafikun e mëposhtëm paraqiten ndryshimet e peshës së shpenzimeve sipas funksioneve dhe burimit të financimit të tyre në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021. Rritjen më të madhe e kanë shpenzimet në funksionin e **“Shëndetësisë” me burim financimi të ardhurat e veta të bashkive me rreth 186%, dhe pas saj funksioni i “Argëtimi, kultura dhe feja” me rritjen nga po ky burim në rreth 53%.** Ndërkohë rënie më të madhe të peshës së financimit nga transfertat e buxhetit qendror për funksionet e **“Rendi dhe siguria publike” me një rënie prej 3%.** Ajo që konstatohet në grafikun e mëposhtëm është rritja e financimit të të gjitha funksioneve vendore nga të 2 burimet më të rëndësishme të buxhetit vendor. Konsolidimi i financimit të të gjitha funksioneve në mënyrë të qëndrueshme në vite është një siguri e shtuar për cilësinë e shërbimeve publike në nivel vendor.

Grafiku 36: Ndryshimi i shpenzimeve sipas funksioneve dhe burimit të financimit gjatë viteve 2022/2021




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Analiza e shpenzimeve të pushtetit vendor sipas burimeve është një aspekt i rëndësishëm që evidenton nivelin e varësisë ndaj transfertave të buxhetit qendror dhe pavarësinë e financimit përmes të ardhurave të veta vendore. Roli i transfertës së pakushtëzuar në financimin e veprimtarisë së pushtetit

vendor është një tregues i rëndësishëm dhe si të tillë në kapitujt e mëposhtëm do ta analizojmë në mënyrë të detajuar. Ashtu siç mund të shihet në grafikun e mëposhtëm, shpenzimet e pushtetit vendor sipas burimit gjatë vitit 2022 janë mbuluar pothuajse në mënyrë të barabartë ndërmjet transfertës së pakushtëzuar dhe të ardhurave të veta vendore. Ky trend i burimit të financimit gjatë vitit 2022 nuk ka ndryshuar krahasuar me një vit më parë.

Në kuadër të thellimit të politikave të decentralizimit fiskal të pushtetit vendor, njësitë e vetëqeverisjes vendore përmes rritjes së kapacitetit fiskal të tyre duhet të synojnë të rrisin peshën e të ardhurave të veta në këtë raport. Reflektimi i këtij raporti do të jetë një pikënisje e rëndësishme për të konsideruar se tashmë politikatat në nivel vendor po japin efekt thelbësor.


Grafiku 37: Peshat e shpenzimeve të pushtetit sipas burimit të financimit për vitet 2022/2021



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Analiza e treguesve jo vetëm në nivel kombëtar por edhe sipas njësive të vetëqeverisjes vendore për burimin e financimit të shpenzimeve në vitin 2022, paraqitet si në grafikun e mëposhtëm. Në këtë rast është qartësisht e evidentueshme varësia e bashkive të vogla nga transfertat e buxhetit qendror dhe bashkive të mëdha nga të ardhurat e veta vendore, kjo reflekton faktin që autonomia fiskale nuk është shtrirë në formë simetrike në të gjithë pushtetin vendor.

Grafiku 38: Pesha e shpenzimeve në nivel njësie sipas burimit të financimit për vitet 2022/2021




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Duke marrë në analizë ndryshimin në shpenzimet e pushtetit vendor nga vitit 2022 në vitin 2021, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore konstatohen diferencat e dhëna si në grafikun e mëposhtëm. Në vitin 2022, konstatohet qartë se ka vazhduar rimëkëmbja e ekonomisë, kjo gjë reflektohet edhe në buxhetet individuale të bashkive të cilat në shumicë janë në rritje. Vetëm **9 bashki nga totali kanë patur një rënie të shpenzimeve në vitin 2022** në raport me shpenzimet e realizuara në vitin 2021. Bashkitë me rënien më të madhe janë bashkitë **Tropojë me një rënie prej 13%, bashkia Gramsh me rreth 9% apo bashkia Delvinë me rreth 8%** të shpenzimeve. Nga ana tjetër, **52 bashki kanë patur të njëjtat shpenzime ose rritje të shpenzimeve në vitin 2022** në raport me vitin 2021. Vetëm **6 bashki kanë patur rritje të shpenzimeve nga 0%-3%, 17 bashki kanë patur rritje nga 4%-10%, 16 bashki kanë patur rritje të shpenzimeve nga 11%-19% dhe 13 bashki kanë patur rritje mbi 20%.** Bashkitë të cilat kanë patur rritjen më të madhe të shpenzimeve gjatë vitit 2022 janë bashkia Kukës me 45% apo bashkia Malësi e Madhe me 37% rritje në raport me vitin 2021.

Ndryshimi i shpenzimeve në rritje në shumicën e njësive të vetëqeverisjes vendore, ku përfshihen kryesisht bashkitë që zënë një peshë të madhe në totalin e shpenzimeve të pushtetit vendor janë një tregues i rëndësishëm i ecurisë pozitive ekonomike që kanë patur njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë vitit buxhetor 2022. Konsolidimi i menaxhimit financiar publik në nivel vendor, duhet të reflektohet në të gjithë treguesit me qëllim ndikimin e drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës së qytetarëve.


Grafiku 39: Ndryshimi i shpenzimeve sipas njësive të vetëqeverisjes vendore 2022/2021.



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Një aspekt i rëndësishëm i kësaj analize është edhe pesha që zënë shpenzimet e secilës njësi ndaj totalit të buxhetit vendor. **Rreth 30.5% të totalit të shpenzimeve të buxhetit vendor e zë Bashkia Tiranë. Me një diferencë mjaft të madhe nga Tirana, peshën më të madhe e zë Bashkia Durrës me 5.6% dhe Bashkia Kamëz dhe Elbasan me 3.4%.**


Grafiku 40: Peshat e shpenzimeve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore ndaj totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor 2022.



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Nëse në analizën grafike do të përjashtojmë Bashkinë Tiranë, situata e peshës së shpenzimeve sipas bashkive ndaj totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor do të paraqitet si në grafikun e mëposhtëm.

Grafiku 41: Pësja e shpenzimeve të njëjësive të vetëqeverisjes vendore (pa bashkinë Tiranë) ndaj totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor 2022




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Një aspekt i rëndësishëm i analizës së shpenzimeve janë grupimi i tyre sipas numrit të banorëve. Si në grafikun e mëposhtëm janë 11 bashkitë të cilat kanë popullsi mbi 100 mijë banorë, të cilat gjatë vitit 2022 kanë shpenzuar rreth **35.3 miliard lekë ose rreth 61%** të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor. Në këtë grup të bashkive, Bashkia Tiranë ka shpenzuar rreth **17.1 miliard lekë ose 29% të shpenzimeve vendore dhe 48%** të totalit të shpenzimeve të këtyrë bashkive mbi 100 mijë banorë. Këto bashki kanë shpenzuar gjatë vitit 2022 rreth **6.6 miliard lekë shpenzime për investime ose rreth 56.8% të të gjithë shpenzimeve për investime të pushtetit vendor dhe 18.7% të shpenzimeve të realizuara nga këto bashki.**

Pjesën më të madhe të shpenzimeve në këto **11 bashki e zënë shpenzimet e personelit me rreth 13.8 miliard lekë ose 40% të totalit të shpenzimeve të këtyrë bashkive. Totali i shpenzimeve të personelit për 11 bashkitë mbi 100 mijë banorë zë rreth 55.2%** të shpenzimeve të personelit të pushtetit vendor.

Grafiku 42: Shpenzimet e bashkive mbi 100 mijë banorë sipas llogarive ekonomike 2022 dhe ndryshimeve 2022/2021




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Si në grafikun e mëposhtëm, paraqiten treguesit e **13 bashkive të cilat kanë një popullsi nga 50 mijë–100 mijë banorë. Ky grup i bashkive gjatë vitit 2022, kanë realizuar rreth 9.5 miliard lekë ose vetëm 16% të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor.**

Shpenzimet për investime të këtij grupi të bashkive janë **1.8 miliard lekë ose 18.9% të të gjitha shpenzimeve të këtij grupi të bashkive dhe vetëm 15.5% të totalit të shpenzimeve për investime të pushtetit vendor.** Nga ana tjetër, shpenzimet e personelit në këtë grup të bashkive janë rreth **4.6 miliard lekë ose 48.4% të totalit të shpenzimeve të tyre dhe vetëm 18.4% të totalit të shpenzimeve të personelit të pushtetit vendor.**

Grafiku 43: Shpenzimet e bashkive me 50 mijë - 100 mijë banorë sipas llogarive ekonomike 2022 dhe ndryshimeve 2022/2021




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Një tjetër aspekt i rëndësishë i analizës janë treguesit e buxhetor të 37 bashkive me një popullsi nën 50 mijë banorë. Totali i shpenzimeve të pushtetit vendor për këtë grup të popullsisë është **rreth 13.1 miliard lekë ose rreth 23% të totalit** të shpenzimeve të pushtetit vendor.

Ky grup i bashkive ka realizuar shpenzime për investime rreth **3.1 miliard lekë ose 37 bashki vetëm 26.7% të totalit të shpenzimeve të pushtetit vendor**. Pesa e shpenzimeve të **investimeve në totalin e buxhetit të këtyre bashkive është rreth 23.6%**. Shpenzimet e personelit janë një tjetër natyrë ekonomike e buxhetit vendor që zë një peshë të konsiderueshme në grupin e këtyre bashkive. Gjatë vitit 2022, këto bashki kanë realizuar rreth **6.5 miliard lekë shpenzime personeli ose rreth 49.6% të totalit të buxhetit të tyre dhe rreth 26% të totalit të shpenzimeve të personelit të pushtetit vendor**.

Grafiku 44: Shpenzimet e bashkive nën 50 mijë banorë sipas llogarive ekonomike 2022 dhe ndryshimeve 2022/2021



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Analiza e mësipërme sipas bashkive të grupuara mbi bazë popullore është një formë e rëndësishme për paraqitjen e ecures së reformës administrative territoriale në bashki të konsideruara të mëdha, të mesme dhe të vogla. Në këtë drejtim pushteti vendor po has sfida të veçanta të cilat nuk reflektojnë të njëjtat argumente për problematika të ndryshme në të gjitha njësitet e vetëqeverisjes vendore.

2.2.1 Shpenzimet dhe të ardhurat e NJVQV-ve sipas popullsisë

Në vitet e fundit ndryshimet strukturore të ekonomisë dhe gjithashtu lëvizjet e kapitalit njerëzor kanë shfaqur problematika të cilat do të analizojmë në këtë seksion. Ndryshimet strukturore në njësitë e vetëqeverisjes vendore pas reformës administrative territoriale kanë bërë që treguesi i popullsisë të referohet ose burimit të census 2011 ose regjistrimit të gjendjes civile. Në kushtet e të dhënave të cilat në të dy rastet sjellin vështirësi për përlogaritjen e shpërndarjes së financiare ndërqeveritare, përmes ligjit vjetor të buxhetit është përdorur një kriter korigjues me termin "Banorë rezident efektive" i cili korigjon diferencat problematike të këtyre burimeve në shpërndarjen e popullsisë ndërmjet bashkive. Në këtë rast treguesi sipas formulës së marrëdhënies korigjuese e këtyre burimeve bëhet në formulën:

$$\text{Banorë rezidentë efektive} = [\text{CENSUS} + (\text{Regjistri i gjendjes civile} - \text{Census}) * 30\%]$$

Në këtë drejtim për të ulur riskun e argumenteve në të dy rastet, në këtë seksion të analizës janë përdorur koncepti i banorë rezidentë efektive si për të ardhurat ashtu edhe për shpenzimet e njësive të vetëqeverisjes vendore.


- Shpenzimet vendore

Pushteti vendor gjatë vitit 2022, ka shpenzuar mesatarisht **rreth 17,431 lekë për banorë**, nga të cilat rreth **3,791 lekë ose vetëm 21.7%** të buxhetit për banor janë përdorur **për investime**, shpenzimet e personelit për banorë rreth 8,550 lekë ose 49% të buxhetit për banor dhe kategoria e shpenzimeve operative dhe të tjera me rreth 5,090 lekë ose 29.3% të buxhetit për banor.

Në nivelin e njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas grafikut të mëposhtëm, kuptohet qartë pesha e madhe që shpenzimet e personelit për banorë zënë tek të gjitha bashkitë. Në këtë drejtim bashkia Himarë ka nivelin më të lartë të **shpenzimeve totale për banorë në rreth 40,385 lekë, dhe pas saj vinë bashkia Kolonjë 28,791 lekë dhe bashkia Përmet me rreth 25,113 lekë**. Nga ana tjetër një nivel mjaft të ulët të shpenzimeve për banorë kanë **bashkia Kurbin me vetëm 9,081 lekë, bashkia Lushnje 11,084 lekë dhe Bashkia Shkodër 11,808 lekë për banorë**. Ajo që konstatohet qartë është ulja e shpenzimeve për banorë në bashki të mëdha me një peshë të ndjeshme në totalin e shpenzimeve vendore

Nëse në analizë do të grupojmë bashkitë sipas popullsisë, 11 bashkitë me numrin më të madh të popullsisë mbi **100 mijë banorë shpenzojnë mesatarisht rreth 15,245 lekë, 13 bashkitë e tjera me një popullsi ndërmjet 100 mijë - 50 mijë banorë shpenzojnë mesatarisht 14,861 mijë lekë, ndërkohë pjesa tjetër e 37 bashkive të vogla me nën 50 mijë banorë shpenzojnë më shumë se të dy kategoritë më lart me mesatarisht 18,985 lekë.**

Grafiku 45: Shpenzimet për banorë sipas kategorive të natyrës ekonomike për vitin 2022.




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Krahasuar me një vit më parë totali i shpenzimeve për banorë ka një ndryshim si në grafikun e mëposhtëm. Gjatë vitit 2022, vetëm 10 bashki kanë një rënie të totalit të shpenzimeve për banorë krahasuar me një vit më parë dhe pjesa tjetër prej 51 bashkive kanë një rritje të ndjeshme të këtyre shpenzimeve.

Bashkitë me rënien më të madhe të shpenzimeve për banorë janë Bashkia Mat me rreth 4,217 lekë, bashkia Tropojë me 2,319 lekë dhe bashkia Gramsh 1,560 lekë krahasuar me vitin 2021.


Nga ana tjetër një rritje të konsiderueshme të shpenzimeve për banorë në vitin 2022, krahasuar më një vit më parë e kanë **bashkia Peqin 8,950 lekë, Bashkia Himarë 6,260 lekë dhe Bashkia Kukës 5,789 lekë.**

Grafiku 46: Ndryshimi i shpenzimeve për banorë ndërmjet 2022/2021.




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Një tjetër aspekt tjetër i rëndësishëm janë shpenzimet e personelit dhe ato të investimeve për banorë në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Në nivel vendor, gjatë vitit 2022, peshën më të madhe të shpenzimeve për banorë e zënë ato të personelit. Të grupuara sipas numrit të popullsisë, bashkitë me **mbi 100 mijë banorë kanë shpenzuar mesatarisht 6,640 lekë gjatë vitit 2022, ndërkohë bashkitë me popullsië ndërmjet 50 mijë -100 mijë banorë kanë shpenzuar 7,372 lekë për banor dhe bashkitë nën 50 mijë banorë kanë shpenzuar 9,590 lekë për banor.** Ajo që konstatohet qartë është fakti që shpenzimet e personelit për banorë rriten ndjeshëm më rënien e numrit të popullsisë. Qytetarëve në bashkitë me **nën 50 mijë banorë, ju kushton rreth 2,950 lekë më shumë për banor kosto e personelit krahasuar në bashkitë me mbi 100 mijë banorë.**



Gjatë vitit 2022, bashkia Shkodër është ajo që ka vlerën më të ulët të **shpenzimeve të personelit per banor me rreth 4,175 lekë dhe pas saj bashkia Kurbin me rreth 5,026 lekë** për banorë. Ndërkohë konstatohet që bashki me një numër relativisht të vogël popullsie, kanë shpenzime për banorë mjaft të larta të tilla **si Skrapari me 16,117 lekë për banorë, Fushë-Arrëzi 15,652 lekë për banorë apo Puka e Pusteci me përkatësisht 14,609 dhe 13, 359 lekë për banorë**. Shpenzimet shumë të larta të personelit për banorë janë tregues që bashkitë e vogla (pavarësisht se nevojitet një analizë gjithëpërfshirëse në cilësinë e shërbimeve) kanë një numër punonjësish të lartë në raport me banorët të cilëve u ofrohet shërbime publike.

Grafiku 47: Shpenzimet e personeli per banorë gjatë vitit 2022



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

“


Por sa përfitoi investime çdo banor gjatë vitit 2022 nga pushteti vendor? Rritja e këtyre shpenzimeve për banorë do të japë një impakt të drejtpërdrejtë në përmirësimin infrastrukturor e si rrjedhim në jetën e qytetarëve. Të grupuara sipas popullsisë, bashkitë me **mbi 100 mijë banorë kanë shpenzuar për investime mesatarisht 2,110 lekë për banor, bashkitë me popullsi ndërmjet 50–100 mijë banorë, 1,654 lekë për banor dhe bashkitë nën 50 mijë banorë mesatarisht 2,557 lekë për banor.** Ajo që vihet re është fakti që pavarësisht se në vlerë absolute bashkitë mbi 100 mijë banorë zënë pjesën më të madhe, krahasuar me numrin e punonjësve këto bashki shpenzojnë më pak se bashkitë nën 50 mijë banorë.

Sipas njësive të vetëqeverisjes vendore, gjatë vitit 2022, bashkitë me vlerën më të vogël të shpenzimeve të investimeve për banor janë **Bashkia Kurbin vetëm 670 lekë, bashkia Vau-Dejes 779 lekë për banor dhe Peqin me rreth 794 lekë për banor.** Vlerat mjaft të ulëta të shpenzimeve të investimeve për banorë të këtyre bashkive janë një tregues negativ i potencialit për impakt në jetën e qytetarëve.

Nga ana tjetër bashkitë me shpenzimet më të mëdha për investime në raport me banorët gjatë vitit 2022, **janë bashkia Himarë me rreth 18,050 lekë për banor, bashkia Dropull me rreth 13,460 lekë për banor dhe gjithashtu bashkia Roskovec me rreth 9,268 lekë për banor.**

”


Grafiku 48: Shpenzimet e investimeve për banorë gjatë vitit 2022




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

- 
- Të ardhurat për banor

Analiza e barrës fiskale është një aspekt i rëndësishëm i treguesve të të ardhurave të veta të pushtetit vendor. Gjatë viti 2022, **pushteti vendor ka mbledhur mesatarisht 5,156 lekë për banor**, ose ndryshe rreth 341 lekë më shumë të ardhura të mbledhura për banor në krahasim me vitin 2021. **Rreth 23 bashki, në vitin 2022 kanë një rënie të barrës fikale krahasuar me një vit më parë, ku rënie më të madhe të barrës fiskale e ka bashkia Mallakastër me rreth 3,103 lekë, bashkia Shijak 2,523 lekë dhe bashkia Vorë me 1,322 lekë.** Ndërkohë pjesa tjetër e 38 bashkive kanë patur një rritje të të ardhurave të veta vendore për banor gjatë vitit 2022, **ku rritjen më të madhe e ka patur bashkia Klos 5,730 lekë, bashkia Cërrik 3,839 lekë dhe bashkia Rrogozhinë 3,142 lekë.**



Grafiku 49: Ndryshimi i të ardhurave për banorë sipas bashkive 2022/2021.



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

“


Bashkitë të cilat kanë një popullsi mbi 100 mijë banorë (11 bashki), gjatë vitit 2022 kanë mbledhur mesatarisht **rreth 7,742 lekë për banor, ndërkohë që bashkitë me popullsi ndërmjet 50–100 mijë banorë (13 bashki) kanë mbledhur vetëm 3,641 lekë për banor** dhe në grupin e fundit janë bashkitë me popullsi nën **100 mijë banorë (37 bashki) të cilat kanë mbledhur rreth 4,919 lekë për banor**. Ajo që konstatohet qartë është kapaciteti fiskal për të mbledhur të ardhura për banorë në bashkitë e mëdha me mbi 100 mijë banorë. Potenciali i të ardhurave nga biznesi dhe familjet është shumë më i madh në këto bashki se në ato me nën 100 mijë banorë. Kjo tregon një shpërndarje të zhbalancuar të strukturës ekonomike, që i krijon vështirësi bashkive të vogla për të krijuar kapacitete fiskale që do ti mundësonin shërbime gjithnjë dhe më cilësore.

Gjatë vitit 2022, në nivelin e njësisive të vetëqeverisjes vendore si në grafikun e mëposhtëm paraqiten të ardhurat për banorë. Bashkia Himarë ka vlerën më të madhe të të ardhurave për banorë me **rreth 45,817 lekë, pas saj Bashkia Tiranë 26,704 lekë dhe bashkia Sarandë me rreth 15,649 lekë**.

Ndërkohë bashkitë me nivelin më të ulët të të ardhurave për banor janë **bashkia Kurbin me 953 lekë për banor dhe bashkia Has me 969 lekë për banor**.

”

Grafiku 50: Të ardhurat sipas njësive të vetëqeverisjes vendore për banor gjatë vitit 2022.



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

2.2.2 Shpenzimet e personelit për numër punonjësish sipas NJVQY-ve




Element i rëndësishëm i analizës janë shpenzimet e personelit në raport me numrin e punonjësve të njësive të vetëqeverisje vendore. Ministria e Financave dhe Ekonomisë në kuadër të hartimit të politikave të menaxhimit financiar në nivel vendor, një aspekt të rëndësishëm ka patur monitorimin e ecurisë së shpenzimeve të personelit. Në këtë aspekt, një ndër objektivat më të rëndësishëm të reformës administrative-territoriale ishte krijimi i një administrate vendore eficiente dhe shmangien e fenomenit të punësimit mbi nevojën reale. Gjatë vitit, 2022 pushteti vendor ka punësuar 36,663 punonjës në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Si në grafikun e mëposhtëm, referuar madhësisë së bashkisë reflektohet edhe numri i punonjësve. Në vitin 2022, Bashkia Tiranë ka të punësuar rreth 7938 punonjës ose ndryshe 21.6% të totali të administratës vendore. Ndërkohë pas saj vjen bashkia Durrës dhe Bashkia Fier me rreth 1737 punonjës dhe 1439 punonjës.


Pjesa tjetër e bashkive të vogla si Pusteci, Libohova apo Konispoli kanë një numër mjaft të vogël punonjësish përkatësisht 83, 90 dhe 121 punonjës.



Grafiku 51: Numri i punonjësve sipas bashkive gjatë vitit 2022




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);




Krahasuar me një vit më parë, numri i punonjësve në pushtetin vendor është rritur me rreth 1960 persona. Bashkia me rritjen më të madhe të numri të punonjësve krahasuar me vitin 2022, është bashkia Shkodër me rreth 427 punonjës më shumë, Bashkia Tiranë me rreth 398 punonjës dhe bashkia Kamëz me rreth 190 punonjës.

Në këtë aspekt rezultojnë edhe bashki të cilat kanë rënie të numrit të punonjësve në vitin 2022 krahasuar me një vit më parë. Bashkia Roskovec ka 10 punonjës më pak, bashkia Mallakastër 8 punonjës dhe bashkia Selenicë po 8 punonjës më pak.


Krijimi i një strukture të qëndrueshme e cila i përgjigjet funksioneve ligjore të pushtetit vendor, duke synuar maksimumin e eficiencës së ofrimit të shërbimit ndaj qytetarëve përbën një objektiv afatgjatë për pushtetin vendor.



Grafiku 52: Ndryshimi i numrit të punonjësve sipas bashkive gjatë vitit 2022/2021



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);



Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë një trend të ngjashëm të shpenzimeve të personelit për punonjës. Gjatë vitit 2022, Bashkia Rrogozhinë ka pagën më të lartë mesatare me rreth 70,915 lekë, bashkia Tiranë rreth 64,133 lekë dhe bashkia Vlorë në rreth 63,134 lekë.

Bashkitë të cilat kanë nivelin më të ulët të pagës mesatare për punonjës janë bashkia Memaliaj me rreth 32,917 lekë dhe bashkia Shkodër 40,933 lekë.

Grafiku 53: Shpenzimet e personelit për punonjës të njëjive të vetëqeverisjes vendore 2022.



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);




Krahasuar me një vit më parë shpenzimet mesatare të personelit për numër punonjës janë si në grafikun e mësipërm. Rreth 41 bashki ose 67% e totalit të bashkive, gjatë vitit 2022 kanë patur një rritje të pagës mesatare për punonjës. Pjesa tjetër prej 20 bashkive ose 33% e tyre kanë pësuar një rënie të pagës mesatare për punonjës, si pasojë e rritjes së numrit të punonjësve.

Në këtë drejtim, evidentohet qartë një rënie mjaft e madhe e pagës mesatare për punonjës si pasojë e rritjes së madhe të numrit të punonjësve në bashki si Memaliaj me rënie rreth 22,281 lekë apo bashkia Shkodër me rreth 16, 587 lekë.

Nga ana tjetër ka njësi të vetëqeverisjes vendore që me performancën pozitive të administrimit kë rritje të pagës mesatare për punonjës, si bashkia Belsh me 5,367 lekë apo bashkia Peqin 4,749 lekë. Është e rëndësishme të theksohet se bashkia Belsh ka rritur pagën mesatare për punonjës duke ruajtur të njëjtin numër si në vitin 2022 ashtu edhe në vitin 2021.



Grafiku 54: Ndryshimi i pagës mesatare për punonjës në nivel bashkie 2022/2021



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Për sa më sipër, rritja e madhe e numrit të punonjësve ka çënuar në disa bashki strukturën ekonomike të pagave duke bërë që paga mesatare për punonjës të zbresë shumë. Në këtë drejtim është i domosdoshëm krijimi i një kuadri rregullator dhe ndihmues për njësitë e vetëqeverisjes vendore në hartimin e strukturave mbështetur mbi katakteristikat demografike, ekonomike dhe natyrore të seilës prej tyre.


2.3 Detyrimet e prapambetura

Stoku i detyrimeve të prapambetura në fund të muajit dhjetor 2022, është rreth **5.4 miliard lekë**. Bazuar në planin e shlyerjes së dërguar nga të gjitha bashkitë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë parashikohet të shlyhen në një periudhë afatmesme të gjitha këto detyrime. Vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura është ulur me rreth **1.2 miliard lekë** krahasuar me stokun në fund të vitit 2021 rreth **6.6 miliard lekë**. **Pas ndërhyrjes së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë duke kërkuar nga njësitë e vetëqeverisjes vendore miratimin e një plani zyrtar për shlyerjen e detyrimeve, konstatohet si në grafikun e mëposhtëm një trend i qëndrueshëm rënës i detyrimeve të prapambetura.**

Stokun më të lartë të detyrimeve e ka **bashkia Tiranë** në vlerën rreth **1.2 miliard lekë**, e cila përbën 22.1% të totalit të detyrimeve. Më pas, **bashkia Kavajë** në vlerën rreth **837.5 milion lekë**, e cila përbën 15.7% të totalit të detyrimeve; **bashkia Vorë** në vlerën e pandryshuar rreth **413 milion lekë**, e cila përbën 7.8% të totalit të detyrimeve; **bashkia Pogradec** në vlerën rreth **278 milion lekë**, e cila përbën 5.2% të totalit të detyrimeve. Më pas renditen bashkia Kamëz dhe Dibër. Konstatohet se bashkia Tiranë, Pogradec, Kamëz dhe Dibër shënojnë ulje të stokut të detyrimeve krahasuar me tremujorin e dytë 2022, ndërsa bashkia Kavajë shënon rritje të stokut të detyrimeve, krahasuar me tremujorin e dytë 2022.

Ndërsa, sa i përket qarqeve, stokun më të lartë të detyrimit vazhdon e ka **qarku Durrës** në vlerën rreth **51.5 milion lekë**, e cila përbën 50% të totalit të detyrimeve; **qarku Berat** në vlerën rreth **39.6 milion lekë**, e cila përbën 38.4% të totalit të detyrimeve; **qarku Gjirokastër** në vlerën **10.4 milion lekë**, e cila përbën 10.1% të totalit të detyrimeve. Më pas renditen qarku Vlorë dhe qarku Korçë. Konstatohet se qarku Durrës shënon rritje të lehtë të stokut të detyrimeve, ndërsa qarku Berat dhe Gjirokastër shënojnë ulje të stokut të detyrimeve, krahasuar me tremujorin e dytë 2022. Ajo që konstatohet në këto detyrime nga këshillat e qarqeve është fakti që si pasojë e mungesës së kapacitetit fiskal të tyre ato kanë mbetur stok në të njëjtin nivel si një vit më parë.

Grafiku 55: Detyrimet e prapambetura të pushtetit vendor në vite




Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Sipas kategorive, peshën më të madhe të stokut të detyrimeve e zë kategoria “Investime” me 44.6%. Më pas, kategoria “Të tjera” 28.2%, “Shërbime” 11.1%, dhe “Vendime Gjyqësore” 7.9%. Ndërsa sa i përket qarqeve, stoku i detyrimit të tyre përbëhet kryesisht nga vendime gjyqësore, të cilat zënë 95.9% të totalit të detyrimit të qarqeve.

Ndërsa sa i përket qarqeve, stoku i detyrimit të tyre përbëhet kryesisht nga vendime gjyqësore, të cilat zënë 96.4% të totalit të detyrimit të qarqeve. Kapaciteti i ulët i të cilave ka bërë që këto vendime mos të shlyhen nga këshillat e qarqeve.

Grafiku 56: Peshat e detyrimeve të prapambetura të pushtetit vendor sipas natyrës



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Ulja e nivelit të detyrimeve të prapambetura të pushtetit vendor është një objektiv i rëndësishëm për të siguruar qëndrueshmërinë financiare të njësive të vetëqeverisjes vendore. Në këtë drejtim, pushteti vendor ka përmirësuar ndjeshëm performancën financiare duke ulur në këtë mënyrë detyrimet e prapambetura në të gjitha kategoritë.

Analizimi i faktorëve të cilat kanë një impakt të rëndësishëm në krijimin e detyrimeve të prapambetura, është moment i rëndësishëm për të listuar risqet të cilat kanë një impakt të drejtpërdrejtë në krijimin e detyrimeve të prapambetura. Në këtë drejtim pushteti vendor gjatë vitit 2022, ndërkohë që ka akumuluar rreth 31 miliard lekë të ardhura të veta vendore dhe ka trashëguar po nga ky burim rreth 13.2 miliard lekë, ka shpenzuar nga të ardhurat e veta vendore rreth 28 miliard lekë.

Një aspekt i rëndësishëm në analizën e detyrimeve të prapambetura janë parashikimet optimiste të të ardhurave të veta vendore të realizuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat përkthehen në angazhime buxhetore mbi kapacitetin normal të njësive të vetëqeverisjes vendore.


2.3.1 Të ardhurat e trashëguara dhe ndikimi në detyrimet e prapambetura

Pas reformës administrativo-territoriale pushteti vendor krijoi kapacitete të reja fiskale dhe kjo u shoqërua më me shumë fonde në dispozicion për financimin e shërbimeve publike në nivel vendor. Problematikat e krijuara nga ana tjetër në menaxhimin financiar bënë që shumë bashki gjatë viteve të akumulonin një stok të konsiderueshëm të “fondeve të trashëguara” si të papërdorura nga një vit më parë.

Në kudër të mirëmenaxhimit financiar në nivel vendor, në këtë seksion do të trajtohen disa elementë të rëndësishëm të impaktit që trashëgimi ka mbi trrguesit fiskale të pushtetit vendor. Nga viti 2022, pushteti vendor ka trashëguar rreth **28.8 miliard lekë nga të cilat 23.6 miliard lekë ose 82.3% janë trashëgim nga buxheti i vetë njësive vendore dhe pjesa tjetër prej 6.2 miliard lekë ose 17.7% janë fonde të trashëguara nga procesi i rindërtimit** të cilat nuk varen nga mirëmenaxhimi financiar i njësive të vetëqeverisjes vendore. Krahasuar me një vit më parë, pushteti vendor ka patur një rritje të trashëgimit më **rreth 3.9 miliard lekë ose ndryshe rreth 20% më shumë fonde të trashëguara**.

Duke i analizuar sipas burimit fondet e trashëguara evidentohen diferencat si në grafikun e mëposhtëm. Gjatë vitit 2022, si pasojë e realizimit faktik të të ardhurave **nga të ardhurat e veta vendore, trashëgimi në pjesën më të madhe prej 62% vjen nga ky burim i të ardhurave**. Pjesa tjetër e fondeve të trashëguara vjen nga burimet e transfertave të buxhetit qendror në rreth 37% të totalit.

Grafiku 57: Trashëgimi i fondeve sipas burimit gjatë vitit 2022



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

Krahasuar me një vit më parë, në fund të vitit 2022 kanë trashëguar më shumë fonde në rreth 34 bashki nga të cilat vetëm bashkia **Tiranë ka trashëguar rreth 14 miliard lekë ose gjysmën e 62.2% të totalit të fondeve të trashëguara.** Bashkia Tiranë krahasuar me një vit më parë ka trashëguar rreth 4 miliard lekë më shumë të ardhura të cilat kryesisht vinë nga të ardhurat e veta vendore. Ajo që bie në sy është një nivel **mjaft i lartë i trashëgimit nga bashkia Himarë me rreth 850 milion lekë dhe bashkia Krujë me rreth 410 milion lekë.**

Për sa më sipër, evidentohet qartësisht tendenca e njësisive të vetëqeverisjes vendore për të rritur nga viti në vit fondet e trashëguara në pjesën e konsiderueshme nga të ardhurat e veta vendore. Njësitë e vetëqeverisjes vendore vendosin në prioritetin e shpenzimeve likuidimin nga transferta e pakushtëzuar për shkak të pasigurisë që vjen nga risku i mosrealizimit të të ardhurave të veta. Trashëgimi i lartë i fondeve ka një faktor të rëndësishëm në mosrealizimin e investimeve në nivel vendor, ku **vetëm bashkia Tiranë ka një diferencë prej 10 miliard lekë mes fondeve të planifikuara dhe realizimit faktik.**

Ajo që është e rëndësishme të identifikohet në këtë analizë, është fakti që njësitë vendore pavarësisht se trashëgojnë shuma të mëdha financiare të papërdorura në fund të vitit, vahdojnë të kenë detyrime të prapambetura të trashëguara. Krijimi i një mekanizimi i cili do të orjentojë njësitë e vetëqeverisjes vendore, që për pesha të caktuara të fondeve të trashëguara të cilat vinë nga mirëmenaxhimi të përdoren në formë të detyrueshme për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, deri në pikën që ato të bëhen zero, është i domosdoshëm.

Në këtë drejtim për të analizuar qartë arsyet mbi këtë rritje periodike të fondeve të trashëguara, si më poshtë janë disa faktorë të rëndësishëm:

Burimet e financimit të pushtetit vendor janë një mjet i rëndësishëm. Qëndrueshmëria e të ardhurave vendore dhe mirëplanifikimi i tyre do ti sigurojë pushtetit vendor kapacitetin për të parashikuar më mirë mjetet financiare në dispozicion për realizimin e shpenzimeve vendore.


Ndryshimi në strukturën buxhetore të njësisive të vetëqeverisjes vendore. Në këtë drejtim, duhet të identifikohen se cila pjesë e fondeve vjen nga burimet e ndryshme dhe si ndahen ato për të mbuluar shpenzimet operative, investimet dhe nevojat e tjera të bashkive. Përcaktimi prioritar i shpenzimeve nga burimet e transferuara nga buxheti qendror dhe me pas nga të ardhurat e veta vendore, është një fenomen që vihet re qartë në rastin e Shqipërisë.

Duhet të vlerësohet qartë **cilësia e menaxhimit financiar në nivel vendor.** Në këtë drejtim cilësia se si njësitë e vetëqeverisjes vendore menaxhojnë financat e tyre ndikon drejtpërdrejt në trashëgimin e fondeve buxhetore. Mënyra se si njësitë e vetëqeverisjes vendore planifikojnë, monitorojnë dhe raportojnë të ardhurat dhe shpenzimet në raport me qëllimet strategjike të zhvillimit vendor, përbën një faktor thelbësor në trashëgimin e pushtetit vendor.

Pëcaktimi i **sfidave dhe problemeve me të cilat haset pushteti vendor** është një formë e rëndësishme për vlerësimin e risqeve për trashëgimin e fondeve. Mungesa e burimeve financiare të mjaftueshme dhe mangësitë në sistemin e raportimit financiar janë risqe potenciale për të krijuar çdo vit fonde të trashëguara.



**3. Menaxhimi Financiar
Publik në nivel vendor
dhe Autonomia Fiskale
Vendore 2022**



“

Konsolidimi i kuadrit ligjor të menaxhimit financiar në nivel vendor pas reformës administrativo-territoriale, po reflektohet në treguesit fiskalë të njësive të vetëqeverisjes vendore. Pavarësisht problematikave të konstatuara në vite në disa prej njësive vendore si në aspektin financiar ashtu edhe në treguesit e zhvillimit, në tërësi ka patur një trend të rëndësishëm zhvillimi. Konsolidimi i kapaciteteve financiare dhe njerëzore të pushtetit vendor dhe përmirësimi i disa nga raporteve të autonomisë vendore të këtij kapitulli tregojnë qartë situatën fiskale të pushtetit vendor.

”

3.1 Të ardhurat e veta vendore ndaj totalit të të ardhurave të NJVQV-ve



Një ndër objektivat më të rëndësishëm të reformës administrativo-territoriale dhe asaj të menaxhimit financiar publik në nivel vendor ishte rritja e treguesit të autonomisë fiskale që vjen si raport i të ardhurave të veta ndaj totalit të të ardhurave të njësive të vetëqeverisjes vendore. Gjatë vitit 2022 të ardhurat e veta të njësive të vetëqeverisjes vendore në nivel kombëtar përfshirë të ardhurat tatimore dhe jotatimore **prej 30.1 miliard lekë**, ndaj të ardhurave totale prej **58.4 miliard lekë** ku përfshihen edhe transfertat e pakushtëzuara dhe sektoriale zënë **rreth 51.5%**.


Referuar treguesve në grafikun pasardhës, konstatohet që **8 bashki kanë një raport të të ardhurave të veta ndaj totalit të të ardhurave për vitin 2022 me mbi 50% të tilla si bashkia Tiranë, Himarë, Sarandë, Vorë, Kavajë, Vlorë, Kamzë, Roskovec**. Ndryshe nga një vit më parë, në këtë grup të bashkive **më një rritje mbi 50% të këtij raporti janë shtuar 2 bashki më shumë**.

Nga ana tjetër, pjesa tjetër e njësive të vetëqeverisjes vendore kanë një tregues të autonomisë financiare nën 50% të të ardhurave të veta ndaj totalit të të ardhurave.

Ndërkohë, nëse në analizë do të përlogaritej mesatarja e këtij raporti, në 61 bashki rreth 33 prej tyre kanë një vlerë më të ulët se mesatarja prej 20% të të ardhurave të veta ndaj totalit të të ardhurave, si tregues i rëndësishëm i autonomisë.



Grafiku 58: Të ardhurat e veta vendore ndaj totalit të të ardhurave sipas bashkive 2022



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

3.2 Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme ndaj të ardhurave të veta të pushtetit vendor




Përcaktimi i ligjorsetransfertaepakushtëzuar dotëjetëjomëpakse1% e PBB-së, i siguroj njësitëve të vetëqeverisjes një burim financiar të qëndrueshëm për financimin e funksioneve ligjore. Në këtë drejtim në nivel kombëtar transferta e pakushtëzuar e shpërndarë me formulë në vitin 2022 është rreth 18.7 miliard lekë, ose ndryshe sa 60.3% e të ardhurave të veta të njësitëve të vetëqeverisjes vendore prej 31 miliard lekë. Të detajuar në nivel bashkie ky raport paraqitet si në grafikun pasardhës.

Një pjesë e konsiderueshme e njësitëve të vetëqeverisjes vendore aktualisht kanë një raport mbi 100% të transfertës së pakushtëzuar ndaj të ardhurave të veta, duke evidentuar në këtë mënyrë nevojën për thellimin e decentralizimit fiskal si formë për të ulur këtë raport. Kryesisht, bashki me një kapacitet fiskal të madh si Tirana, Saranda, Himara apo ato bashki të cilat kanë një burim specifik të të ardhurave si pasojë e pozitës gjeografike apo burimeve natyrore, reflektohet një raport i ulët i transfertës ndaj të ardhurave të veta.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë duhet të nxisë njësitë e vetëqeverisjes vendore në konsolidimin e burimeve nga të ardhurat e veta vendore duke u fokusuar në karakteristikat fiskale të bashkisë. Në këtë drejtim përmes nxitjes së politikave decentralizuese fiskale do të sigurohet në nivel vendor ndryshimi i balancës e këtij raporti në drejtim të rritjes së të ardhurave të veta ndaj transfertës së pakushtëzuar. Ky tregues gjithashtu evidenton nivelin e lartë të varësisë fiskale të shumë njësitëve të vetëqeverisjes vendore si Memaliaj, Malësi e Madhe, Pustec, Has, Bulqizë etj ndaj transfertave të buxhetit qendror.



Grafiku 59: Transfera e pakushtëzuar ndaj të ardhurave të veta sipas bashkive 2022



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

3.3 Transferta e pakushtëzuar sektoriale ndaj të ardhurave të veta të pushtetit vendor




Njësitë e vetëqeverisjes vendore për funksionet e transferuara me ligj, nga viti 2016 e në vazhdim, përfitojnë në formën e transfertës së pakushtëzuar sektoriale një mbështetje buxhetore nga qeveria qendrore. Në vitin 2022 transferta e pakushtëzuar sektoriale ishte **në vlerën rreth 9.3 miliard lekë ose ndryshe rreth 1.1 miliard lekë më shumë se një vit më parë**. Në raport me të ardhurat e veta të njërive të vetëqeverisjes vendore që janë në vlerën rreth **31 miliard lekë**, kjo transfertë për mbulimin e këtyre funksioneve është rreth vetëm 30%. Si në grafikun e mëposhtëm, paraqitet në mënyrë të detajuar sipas njërive të vetëqeverisjes vendore raporti i transfertës së pakushtëzuar sektoriale me të ardhurat e veta.

Bashki të vogla dhe me kapacitet mjaft të ulët fiskal si Fushë-Arrëzi, Hasi, Memaliaj apo Pusteci kanë një raport mjaft të lartë të transfertave sektoriale ndaj totalit të të ardhurave vendore. Kjo tregon pamundësinë fiskale që këto njësi kanë për të ushtruar funksione të decentralizuara pa mbështetje buxhetore. **Këto bashki që kanë një vlerë të lartë të këtij raporti tregojnë që pjesën e konsiderueshme të funksioneve që ato aktualisht ushtrojnë e mbulojnë përmes transfertës së buxhetit qendror.**

Nga ana tjetër, njësitë e vetëqeverisjes vendore të cilat kalsifikohen si të mëdha në raport me buxhetin vjetor 2022, kanë një raport të ulët të transfertës së pakushtëzuar sektoriale me të ardhurat e veta. Ulja e këtij raporti është një sfidë në bashkitë e vogla, në drejtim të nxitjes së rritjes së të ardhurave të veta vendore dhe kapacitetit fiskal që këto njësi kanë në raport me autonominë për të ushtruar funksionet që kanë në bazë të përcaktimeve ligjore.



Grafiku 60: Transferta e pakushtëzuar sektoriale ndaj të ardhurave të veta vendore sipas bashkive 2022



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

3.4 Shpenzimet e personelit ndaj transfertës së pakushtëzuar




Një ndër objektivat më të rëndësishëm të reformës adminisitrativo-territoriale ishte nxitja e njësive të vetëqeverijes vendore për uljen e shpenzimeve të personelit dhe rritjen e shpenzimeve kapitale, që domosdoshmërisht do të ktheheshin në një eficiencë në rritje të menaxhimit financiar në nivel vendor. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2022, **shpenzimet e personelit të njësive të vetëqeverisjes vendore prej 25.2 miliard lekë** në raport me **18.7 miliard lekë që buxheti** qendror jep në formën e transfertës së pakushtëzuar, janë rreth **135%**. Ky tregues në nivel bashkie paraqitet si në grafikun pasardhës.

Si në nivel kombëtar ashtu edhe në nivel njësie vendore, gjatë vitit 2022 bashkitë kanë patur një rritje të shpenzimeve të personelit, tregues ky i cili është reflektuar edhe në raport me transfertën e pakushtëzuar. Aktualisht një pjesë e bashkive si: Tiranë, Gjirokastër, Kavajë, Sarandë, kanë një nivel mjaft të lartë të këtij raporti ne krahasim me pjesën tjetër të bashkive. Ndërkohë, konstatohet një trend i qëndrueshëm i një raporti të përafërt në të gjitha bashkitë ndërmjet shpenzimeve të personelit dhe transfertës së pakushtëzuar.

Njësitë e vetëqeverisjes vendore në raport me këtë tregues duhet të marrin masat që të ulin raportin përmes zvogëlimit të shpenzimeve të personelit. Bashkitë me kapacitet të lartë fiskal njëkohësisht kanë shpenzime të larta personeli të cilat tejkalojnë vlerën e transfertës që këto njësi marrin nga pushteti qendror. Rritja e transfertës dhe ulja e shpenzimeve të personelit do të japë mundësinë njësive të vetëqeverisjes vendore të financojnë më shumë shërbime publike dhe investime që përmirësojnë drejtpërdrejt jetën e qytetarëve.



Grafiku 61: Shpenzimet e personelit ndaj transfertës së pakushtëzuar sipas bashkive 2022



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

3.5 Shpenzime kapitale ndaj transfertës së pakushtëzuar të përgjithshme




Investimet publike në nivel vendor kanë një impakt të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve, dhe si rrjedhim një objektiv i rëndësishëm i reformës territoriale dhe fiskale kishte qëllim krijimin e kushteve për njësitë e vetëqeverisjes vendore të rrisnin shpenzimet kapitale. Në raport me transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme prej **rreth 18.7 miliard lekë**, gjatë vitit 2022, shpenzimet kapitale në vlerën e **rreth 11.9 miliard lekë, zënë 63.6% të transfertës së pakushtëzuar**. Në grafikun pasardhës paraqitet ky raport sipas njësive të vetëqeverisjes vendore.

Rënia e këtij raporti për një pjesë të konsiderueshme të njësive të vetëqeverisjes vendore është një tregues negativ i peshës së shpenzimeve kapitale në buxhetin e bashkive **në raport me transfertën e pakushtëzuar të buxhetit qendror. Pësha e ulët e këtij treguesi për bashki si Vau-Dejës, Tepelenë apo Kurbin etj tregon qartë që pjesa më e madhe e bashkive kanë një nivel të ulët investimesh në raport me burimet e tjera të të ardhurave.**

Në këtë drejtim, marrja e masave në rritjen e shpenzimeve kapitale do të reflektohej drejtpërdrejt në treguesin e raportit ndaj transfertës së pakushtëzuar por gjithashtu edhe në mirëqënien e qytetarëve.



Grafiku 62: Shpenzimet kapitale ndaj transfertës së pakushtëzuar sipas bashkive 2022



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

3.6 Shpenzime kapitale ndaj të ardhurave të veta vendore




Njësiti e vetëqeverisjes vendore gjithnjë dhe më shumë duhet që përmes të ardhurave të veta të financojnë shpenzimet për investime. Rritja e shpenzimeve për investime të pushtetit vendor në raport me të ardhurat e veta që NJVQV-të krijojnë është një tregues i qartë i eficiencës së menaxhimit financiar. Gjatë vitit 2021, pushteti vendor ka realizuar rreth **11.9 miliard lekë shpenzime për investime** dhe në raport me **të ardhurat e veta vendore prej rreth 31 miliard lekë**, këto shpenzime zënë **vetëm 38.3%**. Kjo peshë e ulët e shpenzimeve kapitale është një tregues për nxitjen e pushtetit vendor në drejtim të forcimit të investimeve të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve. **Në grafikun pasardhës paraqitet ky raport gjatë vitit 2022 për të gjitha NJVQV-të.**

Duke marrë në analizë vërehet që si pasojë e nivelit të ulët të të ardhurave të veta vendore në disa bashki si Selenicë, Pustec, Klos, Dropull, Bulqizë, Tropojë etj, ky raport është mjaft i lartë në mbi 100%. Ndërkohë, në bashki me kapacitet të lartë fiskal si Tiranë, Vlorë, Durrës, Elbasan, Fier, Korçë etj, kanë një nivel nën 50% të këtij raporti.

Për sa më sipër, nisur nga ky tregues, del e nevojshme që njësiti e vetëqeverisjes vendore të rrisin nivelin e shpenzimeve për investime jo vetëm nga të ardhurat e veta por nga të gjitha burimet, përfshirë këtu transfertat e buxhetit qendror.



Grafiku 63: Shpenzimet kapitale ndaj të ardhurave të veta vendore sipas bashkive 2022



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

3.7 Detyrimet e parapambetura ndaj totalit të ardhurave të veta vendore



Një shqetësim për Ministrinë e Fiancave dhe Ekonomisë është krijimi i detyrimeve të parapambetura të cilat gjatë vitit 2022 pavarësisht se kanë ardhur në rënie, synimi mbetet ulja e tyre në maksimum. Një aspekt i rëndësishëm i analizës mbi detyrimet e parapambetura të njësive të vetëqeverisjes vendore është evidentimi i arsyes kryesore pse këto detyrime krijohen si dhe përse stoku i tyre nuk ka pësuar një rënie të ndieshme në vite. Gjatë vitit 2022, raporti i stokut të **detyrimeve të parapambetura prej rreth 5.4 miliard lekë**, ndaj totalit të të ardhurave të veta faktike prej rreth 31 miliard lekë rezulton të jetë prej **rreth 17.4%**. Krahasuar me një vit më parë, si rrjedhojë e rritjes së të ardhurave të veta dhe rënies së stokut të detyrimeve ky raport është zvogluar **me rreth 3.4%**. Si në grafikun e mëposhtëm, paraqitet raporti i stokut të detyrimeve të parapambetura ndaj të ardhurave të veta vendore sipas bashkive.


Në grafikun e mësipërm konstatohen që një pjesë e bashkive si Vora, Tropojë, Malësi e Madhe, Belsh, Cërrik etj kanë një raport mjaft të lartë mbi 100% të stokut të detyrimeve të vitit 2022 ndaj të ardhurave të veta që këto njësi kanë realizuar. Kapaciteti fiskal mjaft i ulët i këtyre bashkive dhe menaxhimi jo i mirë i mbledhjes së të ardhurave dhe planifikimit të shpenzimeve ka krijuar këto problematika në stokun e detyrimeve.

Nga ana tjetër, pjesa më e madhe e NJVQV-ve si: Tiranë, Shkodër, Korçë, Himarë, Dropull etj, kanë një raport mjaft të ulët të stokut të detyrimeve në vitin 2022 mbi të ardhurat e veta. Kapaciteti fiskal i qëndrueshëm dhe cilësia e lartë e menaxhimit financiar është treguesi më i rëndësishëm i këtyre bashkive që do të reflektohet në cilësinë e shërbimeve ndaj qyteratëve.

Për sa më sipër, njësitë e vetëqeverisjes vendore që kanë një raport mbi 100% të stokut të detyrimeve ndaj të ardhurave të veta faktike, duhet të marrin masa të menjëhershme jo vetëm në drejtim të shlyerjes së detyrimeve por gjithashtu të rritjes së kapacitetit fiskal.



Grafiku 64: Detyrimet e prapambetura ndaj totalit të ardhurave të veta vendore sipas bashkive 2022



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

3.8 Detyrimet e prapambetura ndaj planit të shpenzimeve vjetore




Për të evidentuar më qartë problematikën e krijimit të detyrimeve të prapambetura, ato janë vendosur në raport me planin e shpenzimeve vjetore të parashikuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore. Gjatë vitit 2022 **në nivel kombëtar, stoku i detyrimeve të prapambetura prej 5.4 miliard lekë zë rreth 6.3% të totalit të planit të shpenzimeve të njësive të vetëqeverisjes vendore prej 84.7 miliard lekë të miratuara. Në raport me një vit më parë ky tregues ishte 8.8%, konstatohet një rënie me rreth 2.5%, duke përmirësuar në këtë mënyrë treguesin e performancës së njësive.** Si në grafikun e mëposhtëm, ky raport gjatë vitit 2022 paraqitet për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Ashtu siç mund të konstatohet në grafikun e mësipërm, me përjashtim të bashkisë Belsh dhe Kavajë ku ky raport kalon raportin mbi 50% të detyrimeve të prapambetura ndaj planit fillestar **të shpenzimeve**, pjesa tjetër e të gjitha njësive të vetëqeverisjes vendore janë në një raport mjaft të ulët.

Ky tregues evidenton qartë faktin që kapaciteti i ulët fiskal dhe parashikimi jo realist i planit të shpenzimeve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë vitit 2022 janë arsyet kryesore të rritjes së stokut të detyrimeve të prapambetura të njësive të vetëqeverisjes vendore. Krijimi i një plani realist të të ardhurave të veta vendore duke shmangur në këtë mënyrë marrjen e agazhimeve buxhetore mbi të cilin ka kapacitet fiskal bashkia, është masa imediate e cila do të shmangë rritjen e stokut aktual të detyrimeve të prapambetura dhe uljen e tij në të ardhmen.



Grafiku 65: Detyrimet e prapambetura ndaj planit të shpenzimeve vjetore sipas bashkive 2022



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);

3.9 Transferta e buxhetit qendror ndaj të ardhurave të veta vendore.




Pas reformës adminstrativo territoriale, një aspekt i rendësishëm për menaxhimin financiar në nivel vendor ishte rritja e autonomisë fiskale të njësive të vetëqeverisjes vendore në raport me transfertat që ato njësi presin nga qeveria qendrore. Në këtë aspekt, gjatë vitit 2022, në nivel kombëtar njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë marrë në formën e transfertës së pakushtëzuar së përgjithshme dhe sektoriale **rreth 28 miliard lekë**, ku në raport me të ardhurat e veta vendore prej 31 miliard lekë, ato janë **sa 90.3% e të ardhurave të veta vendore. Krahasuar me një vit më parë ky raport ka një rënie prej 3.7%, pasi gjatë vitit 2021 ky raport ishte 94%**. Ky raport në nivel bashkie paraqitet në grafikun që vijon.

Për sa konstatohet në grafikun e mësipërm, shumë njësi të vetëqeverisjes vendore kanë një raport mjaft të lartë të transfertës së buxhetit qendror ndaj të ardhurave të veta vendore. Ky tregues për bashki të tilla si Memaliaj, Pustec, Fushë-Arrëz me një kapacitet mjaft të ulët fiskal, tregon varësinë e lartë që kanë këto bashki nga transfertat e buxhetit qendror. Ky tregues tregon qartë që pas reformës mungesa e një decentralizimi fiskal të thelluar është reflektuar në një nivel të lartë varësie, ndërkohë që një pjesë e konsiderueshme e bashkive kanë kapacitet të ulët fiskal për të financuar shpenzimet për shërbime publike.


Në këtë drejtim, me qëllim për të nxitur politikat vendore për përmirësimin e shërbimit ndaj qytetarëve duhet të merren masat e nevojshme për uljen e këtij raporti. Krijimi i bashkive me kapacitet të lartë fiskal përmes thellimit të decentralizimit të burimeve të veta vendore do të jetë një siguri në drejtim të rritjes së cilësisë së shërbimeve publike dhe përmirësimin të jetës së qytetarëve.



Grafiku 66: Transferata e buxhetit qendror ndaj të ardhurave të veta vendore sipas bashkive 2022



Burimi: Drejtoria e Financave Vendore, Ministria e Financave dhe Ekonomisë (2023);



4. Decentralizimi dhe treguesit fiskal vendor krahasuar me vendet e rajonit dhe OECD

Një aspekt i rëndësishëm i analizës së Financave Vendore është krahasimi me vendet e tjera të rajonit apo OECD, për të evidentuar treguesit pozitiv apo trendet negative në rastin e Shqipërisë. Pavarësisht përmirësimeve të dukshme ndër vite të treguesve të pushtetit vendor, në objektivat afatgjatë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë është përafrimi me treguesit fiskalë të pushtetit vendor në vendet e rajonit apo OECD-së.

Krahasimi i treguesve ndërmjet vendeve sigurisht që është një proces kompleks kjo për faktin sepse vende të ndryshme kanë tipare të veçanta të cilat duhen analizuar sipas rastit. Në këtë drejtim për të arritur rezultate sa më të sakta në këtë seksion u jemi referuar treguesve të ngjashëm të pushtetit vendor ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera. Disa nga risqet kryesore të analizës krahasimore ndërmjet vendeve janë:

Niveli i rritjes ekonomike e cila shprehet përmes diferencës së Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), në Shqipëri është i ndryshëm në krahasim me vendet e tjera të OECD-së apo rajonit, duke treguar performancë ekonomike të ndryshme. Nga ana tjetër, **niveli i inflacionit** ka një ndikim në fuqinë blerëse të konsumatorëve dhe në stabilitetin ekonomik të vendeve të caktuara.


Një tjetër risk i rëndësishëm krahasimor është **niveli i taksave dhe tatimeve** në Shqipëri apo vende të tjera, kjo mund të ndikojë në konkurrueshmërinë fiskale të vendit dhe në të ardhurat e qeverisë. Vende të ndryshme përdorin regjim të ndryshëm fiskal që i përputhet karakteristikave sociale, kulturore apo natyrore.

Por si qëndron Shqipëria në nivelin e autonomisë krahasuar me vendet e tjera? Sigurisht është e qartë se sa më e lartë të jetë përqindja e transfertave ndërqeveritare, aq më e madhe është varësia financiare e Pushtetit Vendor nga nivelet e tjera të qeverisjes dhe aq më e ulët është autonomia vendore.

Duke ju referuar grafikut të mëposhtëm dhe të dhënave zyrtare, mesatarja e këtij raporti në vendet evropiane **të OECD është 49.84%, tregues ky i një varësie të fortë të Pushtetit Vendor nga transfertat ndërqeveritare**. Në 13 nga 26 vendet e OECD, transfertat ndërqeveritare përfaqësojnë pjesën më të madhe të buxhetit vendor, duke zënë 50% ose më shumë të të ardhurave vendore. Lituania, Estonia, Republika Sllovake dhe Holanda janë vendet me përqindjen më të lartë të transfertave ndërqeveritare, përkatësisht me një peshë prej 87.98%, 85.87%, 77.83% dhe 74.74%.

Ndër 13 vendet e tjera, Islanda dhe Zvicra kanë peshën më të ulët: transfertat ndërqeveritare përbëjnë vetëm 8,84% (Islanda) dhe 10,45% (Zvicër) të të ardhurave vendore.

Grafiku 67: Transfertat ndërqeveritare ndaj totalit të të ardhurave të pushtetit vendor (2021)



Burimi: Centre for Public Administration Research, OECD Fiscal Decentralization database (2023);


Krahasuar me këto vende shqipëria ruan trende të ngjashme me një përqindje prej rreth 47% të transfertave ndërqeveritare (transfertë e pakushtëzuar dhe sektoriale). Forcimi i kapacitetit fiskal të pushtetit vendor në shqipëri është një aspekt i rëndësishëm i uljes së këtij raporti në vite. Përmes thellimit të decentralizimit fiskal në përputhje me objektivat e strategjisë do të jetë një hap i rëndësishëm për të konsoliduar këtë raport krahasuar me vendet e tjera të Europës.

- Treguesit e transfertave ndërqeveritare

Pushteti vendor është një kontributor i rëndësishëm i rëndësishëm në Produktin e Brendshëm Bruto të një vendi. Niveli i kontributit është i ndryshëm në vende të ndryshme, dhe si rrjedhim vlerësimi i nivelit të transfertës ndërqeveritare që përfiton pushteti vendor në raport me PBB-në është një moment i rëndësishëm krahasimi.

Si në grafikun e mëposhtëm vendet e OECD-së mesatarisht shpërndajnë në formën e transfertës ndërqeveritare rreth 5.53% të Produktit të Brendshëm Bruto për pushtetin vendor. Ndërkohë Shqipëria është pothuajse në limitin e përcaktimit ligjor në vetëm 1.1%

Grafiku 68: Transfertat ndërqeveritare ndaj produktit të brendshëm bruto (2013-2021)




Burimi: OECD Fiscal Decentralization database (2023);

Ashtu siç mund të konstatohet në grafikun e mësipërm, vende të EU me një decentralizim funksional dhe fiskal mjaft të thelluar të tilla si Austria, Italia apo Sllovakia kanë një përqindje të lartë të Produktit të Brendshëm Bruto që shkon si transfertë ndërqeveritare, përkatësisht 11.5%, 8.3% apo 6%. Është qartësisht e evidentuar në grafik, me përjashtim të Hungarisë e cila ka një rënie të këtij raporti nga viti 2013 e në vazhdim, të gjitha vendet e tjera kanë rritur peshën e transfertave ndaj PBB-së ndër vite.

Në këtë kontekst, shqipëria mbetet në vendet me nivelin më të ulët të transfertave ndërqeveritare në raport me produktin e brendshëm burto krahasuar jo vetëm me vendet e OECD por edhe rajonit.

Angazhimi i qeverisë për të ndarë me pushtetin vendor një pjesë të shpenzimeve publike në formën e transfertave ndërqeveritare, është një aspekt i cili tregon vëmendjen që kanë siguruar shërbimet publike në nivel vendor. Mesatarisht për vitin 2021 vendet e OECD kanë një raport të transfertave ndërqeveritare ndaj shpenzimeve publike në rreth 9.6%, ose në përqindje krahasuar me Shqipërinë rreth 6.5% më shumë. Ashtu si pothuajse në shumicën e treguesve edhe në këtë pikë Shqipëria ka planifikuar në vitin 2021 një vlerë mjaft të ulët ose rreth 3.1% të shpenzimeve publike në formën e transfertës së pakushtëzuar.

Grafiku 69: Transfertat ndërqeveritare ndaj shpenzimeve publike (2013-2021)



Burimi: OECD Fiscal Decentralization database (2023);


Vende të zhvilluara si Austria, Estonia, Italia etj, me një nivel të lartë të decentralizimit të shërbimeve publike gjatë vitit 2021 kanë një peshë të këtij raporti përkatësisht 16.5%, 16.8% dhe 13.2%. Ashtu si qartësisht evidentohen në grafikun e mësipërm, vende si Estonia, Çekia apo Sllovenia kanë pësuar një rritje të këtij raporti në vitin 2021 krahasuar me vitin 2013. Ndërkohë Shqipëria paraqet një trend të lehtë rritës të raportit të transfertës së pakushtëzuar ndaj shpenzimeve publike, kryesisht pas reformës administrativo-territoriale dhe miratimit të kuadrit ligjor për menaxhimin financiar në nivel vendor.

- Treguesit e shpenzimeve vendore

Shpenzimet e pushtetit vendor, në varësi të nivelit të decentralizimit por gjithashtu edhe të rolit që pushteti vendor ka në shërbimet publike kanë raport të ndryshëm të shpenzimeve vendore ndaj Produktit të Brendshëm Bruto. Mesatarisht vendet e OECD-së kanë një raport të shpenzimeve vendore ndaj

Produktetit të Brendshëm Bruto që është rreth 10.3%. Evidentohet që në varësi të nivelit zhvillimor të vendit edhe ky raport është i ndryshëm. Vende si Danimarka, Austria apo Çekia kanë një raport mjaft të lartë të shpenzimeve vendore ndaj PBB-së përkatësisht 32.1%, 8.1% dhe 12.3%.

Grafiku 70: Shpenzimet vendore ndaj Produktit të Brendshëm Bruto (2013-2021)




Burimi: OECD Fiscal Decentralization database (2023);

Shqipëria gjithashtu në këtë tregues ka një raport mjaft të ulët të shpenzimeve vendore ndaj PBB-së në vetëm 3.4%. Si në grafikun e mësipërm, te gjitha vendet e EU, përfshirë këtu edhe Shqipërinë, nga viti 2013 e në vazhdim kanë patur një trend të lehtë rritës të peshës së shpenzimeve vendore ndaj PBB-së.

Shqipëria në këtë aspekt, pavarësisht nivelit mjaft të ulët të këtij raporti, ndër vite ka ndjekur një trend rritës së kësaj peshe. Kontributi i pushtetit vendor në prodhimin e brendshëm bruto të vendit është thelbësor për të konsoliduar rëndësinë që kanë shpenzimet vendore për cilësinë e shërbimeve publike.

Pushteti vendor në tregusit fiskal të konsoliduar dhe ato makroekonomikë është pjesë integrale e qeverisjes së përgjithshme, si rrjedhim pesha e shpenzimeve vendore ndaj atyre të qeverisjes së përgjithshme është tregues për rritjen e rolit të pushtetit vendor në shërbimet publike. Gjatë vitit 2021, mesatarisht vendet e OECD-së kanë një raport të shpenzimeve vendore ndaj shpenzimeve publike në rreth 22.6%. Vlen të theksohet që vende të zhvilluara europiane të tilla si Danimarka, kanë shpenzime vendore më shumë se sa ato qendrore, duke bërë që ky raport për vitin 2021 të jetë rreth 63.2%.

Grafiku 71: Shpenzimet vendore ndaj totalit të shpenzimeve publike (2013-2021)



Burimi: OECD Fiscal Decentralization database (2023);


Shqipëria nga viti 2013 e në vazhdim ka ruajtur një trend të lehtë rritës të këtij raporti të shpenzimeve vendore ndaj totalit të shpenzimeve publike. Në vitin 2021 ky tregues është rreth 9.6%, një vlerë goxha me e ulët se vendet e tjera të europës. Gjatë vitit 2021, vendet e europës si Çekia, Austria dhe Sllovenia kanë një raport mjaft të lartë përkatësisht 27.6%, 14.5% dhe 18.1%.

Në grafikun e mësipërm, evidentohet që gjatë viteve të fundit pothuajse të gjitha vendet e EU kanë patur një rënie të këtij raporti dhe ndryshe nga këto Shqipëria ka ardhur në rritje. Kosnolidimi i menaxhimit të shpenzimeve vendore dhe rritja e cilësisë apo numrit të shërbimeve publike që ofrohen nga pushtetit vendor do të jenë momente të rëndësishme për decentralizimin në Shqipëri.

- Treguesit e të ardhurave vendore

Të ardhurat e veta janë një tregues i rëndësishëm i nivelit të autonomisë fiskale që pushteti vendor ka në vende të ndryshme. Mesatarisht vendet e OECD-së gjatë vitit 2021 kanë një raport rreth 4.8% të të ardhurave të veta vendore ndaj të ardhurave publike. Raportin më të madh të këtij treguesi e kanë vende si Danimarka, Çekia, Sllovenia me përkatësisht 14.4%, 8.1% dhe 5%.

Grafiku 72: Të ardhurat e veta vendore ndaj Produktit të Brendshëm Bruto (2013-2021)




Burimi: OECD Fiscal Decentralization database (2023);

Shqipëria ka një nivel mjaft të ulët të të ardhurave të veta në raport me produktin e brendshëm bruto. Gjatë vitit 2021, pushteti vendor në shqipëri siguron të ardhura nga burimet e veta në vetëm 1.5% të produktit të brendshëm bruto. Ajo që vihet re në grafikun e mësipërm, është një trend rënës në vite i këtij treguesi në të gjitha vendet e EU, ndërkohë Shqipëria ka ruajtur një trend shumë të lehtë rritës në vite.

Rritja e autonomisë vendore, nuk ka kuptim pa rritjen e konsiderueshme të raportit të të ardhurave të veta vendore ndaj produktit të brendshëm bruto. Thellimi i decentralizimit fiskal në vitet e ardhshme, ka rritur pritshmëritë e forcimit të rolit të pushtetit vendor në mbledhjen e të ardhurave nga burimet e veta.

Madhësia e pushtetit vendor në kapacitet fiskal matet përmes raportit të të ardhurave të veta vendore me të ardhurat publike të qeverisë së përgjithshme. Mesatarisht gjatë vitit 2021, vendet e OECD-se kanë një raport prej 10.2% të të ardhurave nga burimet e veta vendore me të ardhurat totale publike të qeverisjes së përgjithshme. Vende me një ecuri pozitive në drejtim të konsolidimit të autonomisë vendore, kanë një raport të lartë të tilla si Danimarka, Çekia, Sllovenia përkatësisht 26.5%, 19.5% dhe 11.1%.

Grafiku 73: Të ardhurat e veta vendore ndaj të ardhurave publike (2013-2021)



Burimi: OECD Fiscal Decentralization database (2023);

Ky tregues është mjaft i rëndësishëm për Shqipërinë krahasuar me disa nga vendet europiane të OECD-së të cilat kanë një raport më të ulët të të ardhurave të veta ndaj totali të të ardhurave publike. Gjatë vitit 2021, Shqipëria ka të ardhurat të veta vendore rreth 5.2% të të ardhurave publike, tregues ky më i madh se shtete europiane si Sllovakia, Greqia apo Estonia të cilat kanë një raport përkatësisht 4.2%, 2.9% dhe 3.5%.

Në këtë drejtim pushteti vendor në Shqipëri ka reflektuar një rritje më të shpejtë të të ardhurave nga burimet e veta vendore, krahasuar me të ardhurat e buxhetit qendror. Në këtë drejtim përmirësimi i kapacitetit fiskal të pushtetit vendor është një premisë mjaft pozitive për decentralizim fiskal të burimeve të tjera të të ardhurave nga qeveria qendrore.

The background features a large teal area on the left and bottom. On the right, there are several overlapping geometric shapes: a red triangle at the top, a dark blue trapezoid below it, a light blue trapezoid below that, and a green trapezoid at the bottom right. These shapes are filled with various patterns of horizontal or diagonal lines in different colors (red, blue, green, orange).

5. Përfundime dhe Rekomandime

Rritja e cilësisë së menaxhimit financiar në të gjithë komponentët e tij, përmirësimi i treguesve të ecurisë së decentralizimit fiskal e funksional, ishin prioritete të rëndësishme të Minsitrisë së Financave dhe Ekonomisë gjatë vitit 2022. Në vijim të punës së zhvilluar për ndjekjen e ecurisë së implementimit të politikave publike në drejtim të forcimit fiskal dhe menaxhimit financiar, janë evidentuar disa konkluzione të cilat do të shërbejnë si pikënisje për tu rregulluar në vitin 2023. Gjatë vitit 2023, synohet të ruhen treguesit pozitivë të rritjes së rolit të pushtetit vendor në ofrimin e shërbimeve publike sa më afër qytetarëve. Ruajta e trendit pozitiv të ecurisë së konsolidimit financiar në nivel vendor dhe zbatimi i plotë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore i të gjitha metodologjive të hartuara janë tregues të rëndësishëm për shëndetin financiar të pushtetit vendor për vitin në vazhdim. Në këtë këndvështrim, disa nga konstatimet që dalin nga raporti i treguesve të realizimit të buxhetit vendor 2022, si dhe prioritetet për buxhetin vendor 2023 janë si më poshtë:

- Rritja e kapacitetit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore

Rritja e të ardhurave të veta të njësive të vetëqeverisjes vendore, si tregues i forcimit të kapacitetit fiskal është e rëndësishme për konsolidimin financiar të pushtetit vendor. Thellimi në analizën e kapacitetit sipas njësive të vetëqeverisjes vendore është thelbësor për t'u zhvilluar gjatë vitit 2023, me qëllim për të identifikuar kapacitetet e decentralizimit aktual fiskal dhe evidentimin e mundësive të reja në kuadër të këtij procesi. Rritja e burimeve të financimit të qeverisjes vendore me rreth 5.2 miliard lekë ose 8.8 % më shumë se sa plani i vitit 2022, është rritje e cila sigurohet nga transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme dhe sektoriale dhe të ardhurat nga taksat e tarifave vendore. Kjo rritje krijon hapësirat e nevojshme për përmirësimin e shërbimeve publike dhe fokusim më të madh në shpenzimet për investime.

Një ndër treguesit më të rëndësishëm të konsolidimit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore do të jetë rritja e aftësive të tyre për të siguruar të ardhura nga burimet e veta dhe arkëtimin e tyre në mënyrë të qëndrueshme në kohë. Gjatë vitit 2022, pushteti vendor siguroi një rritje të rëndësishme të të ardhurave në raport me planin, tregues ky i kapacitetit në rritje të njësive për të siguruar qëndrueshmërinë e financimit të funksioneve. Taksa mbi pasurinë, është një burim i rëndësishëm i të ardhurave vendore përmes së cilit njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të zhvillojnë politika vendore nën diskrecionin e plotë të përdorimit. Vitet e fundit në politikën qeveritare, hartimi i metodologjisë së vendosjes së kësaj takse në bazë vlere por dhe ndërtimi i një kadastrë të detajuar mbi pronën, përbëjnë thelbin e reformës mbi këtë burim financimi të njësive të vetëqeverisjes vendore. Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të ndjekë me prioritet ruajtjen e qëndrueshmërisë së rritjes së të ardhurave vendore edhe në buxhetin e vitit 2023.

- Harmonizimi dhe unifikimi i procedurave për hartimin, zbatimin, raportimin, monitorimin e buxheteve të njësive të vetëqeverisjes vendore, konform standarteve ndërkombëtare;

Po punohet intensivisht për thellimin e metodologjive të menaxhimit financiar në nivel vendor në standardet më të mira ndërkombëtare. Përmirësimi i këtyre standardeve do të përfshijë të gjitha hapat e ciklit të menaxhimit financiar në nivel vendor, duke synuar në këtë mënyrë mbylljen e kuadrit nënligjor të MFP në pushtetin vendor.

- Konsolidimi fiskal dhe qëndrueshmëria e financave të pushtetit vendor gjatë vitit 2023, do të jenë tregues i rëndësishëm i forcimit të aftësisë së pushtetit vendor për ofrimin e shërbimeve publike.

Në këtë drejtim do të ruhet qëndrueshmëria e transfertës së pakushtëzuar pavarësisht problemeve të shkaktuara si pasojë e krizës ekonomike e cila goditi ekonominë e vendeve të zhvilluara dhe rajonin, si dhe krizës energjitike si rrjedhojë e luftës në Ukrainë.

- Ruajtja e standardeve ligjore për buxhetimin mbi bazë produkti, programi dhe funksioni në të gjitha njësitë vetëqeverisjes vendore;

Gjatë vitit 2023, njësitë e vetëqeverisjes vendore, do të konsolidojnë ecurinë e përdorimit të standartit të unifikimit të shpenzimeve vendore, jo vetëm në nivel llogarie ekonomike por gjithashtu edhe produkti, programi e funksioni. Buxhetimi në nivel produkti, është një ndër objektivat e rëndësishme përmes së cilit synohet që njësitë e vetëqeverisjes vendore të kostojnë produktet e shërbimeve që ofrojnë për qytetarët. Gjatë vitit 2023 do të monitorohet pilotimi i tre bashkive në përgatitjen e buxhetit me një numër të reduktuar programesh dhe detajimin deri në nivel produkti. Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të vijojë punën për të konsoliduar buxhetimin në nivel produkti tek të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore. Përfundimi i këtij procesi do të përmbyll një etapë të rëndësishme në rrugën drejt unifikimit në AFMIS të të gjithë njësive të vetëqeverisjes vendore.

- Zhvillimi ekonomik lokal dhe ulja e pabarazive midis njësive të vetëqeverisjes vendore.

Përmes politikave të reja të menaxhimit financiar, do të synohet ulja e diferencave dhe sigurimi i një financimi të qëndrueshëm në nivel vendor. Pushteti vendor si pjesë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik kombëtar ka në thelb nxitjen e politikave të zhvillimit rajonal. Instrumentet financiarë të vetëqeverisjes vendore do të të orientohen në funksion të zhvillimit ekonomik dhe uljen e pabarazive midis njësive në funksion të zhvillimit kombëtar.

- Implementimi i AFMIS në nivel vendor.

Në funksion të reformimit dhe modernizimit të financave publike dhe kryesisht atyre vendore, në strategjinë e Menaxhimit të Financave Publike është parashikuar që në vitet e ardhshme në sistemin IPSIS të përfshihen dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore. Po ashtu strategjia e MFP-së parashikon që edhe AFMIS-i të jetë i zgjeruar dhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore. Këto sisteme (IPSI dhe AFMIS) që parashikohet të jenë funksionale në vitet e ardhshme do të jenë një vlerë e shtuar e Menaxhimit Financiar Publik në nivel vendor. Ato do

të unifikojnë të gjithë punën dhe operacionet financiare në të gjitha fazat dhe ciklet e menaxhimit financiar, do të mundësojnë një komunikim të efektshëm midis institucioneve dhe njësive qendrore me ato vendore dhe do të jenë një garanci më shumë për përdorimin e fondeve publike me efikasitet, ekonomi dhe efektshmëri.

- Monitorimi më i rreptë i mekanizmave që nxisin rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së qeverisjes vendore në raport me komunitetin.

Në këtë drejtim për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë një sfidë e rëndësishme për tu thelluar në qeverisjen vendore mbetet rritja e transparencës dhe llogaridhënjes përmes pjesëmarrjes qytetare në proceset e përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm. Një pushtet vendor i konsoliduar do të thotë një transparencë më e madhe në lidhje me punën e zhvilluar për arritjen e objektivave. Mangësitë e konstatuara në këtë raport gjatë vitit 2022, do të monitorohen periodikisht nga MFE. Në këto kushte, gjatë vitit 2023 e në vazhdim Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të synojë nxitjen e njësive të vetëqeverisjes vendore për të publikuar dhe bërë pjesë të politikave publike sa më shumë qytetarët, duke përmirësuar kështu transparencën në publikimin dhe hartimin e programit buxhetor afatmesëm dhe buxhetit vjetor.

- Forcimi i rregullave dhe procedurave për menaxhimin e financave publike në nivel vendor duke siguruar më shumë disiplinë fiskale në menaxhimin e vështirësive financiare;

Duke ndjekur trendin e viteve të pas reformës administrative territoriale, gjatë vitit 2023 do të synohet rritja e kapacitetit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore dhe gjithashtu përmirësimi i shërbimeve publike të ofruara për qytetarët. Ministria e Financave dhe Ekonomisë në mënyrë të vazhdueshme do të ndjekë e monitorojë procesin e menaxhimit financiar në nivel vendor dhe përmes tij vlerësimin e treguesve të performancës së NJVQV-ve. Në këtë kuptim, ky raport do të vijohet nga raporte të tjerë zyrtarë periodike të ndërmjetëm për vitin 2023, në funksion të transparencës, përgjegjshmërisë dhe pjesëmarrjes së të gjitha grupeve të interesit në procesin e administrimit financiar vendor por gjithashtu ajo që është më e rëndësishmja pjesëmarrja qytetare në këtë proces.

- Rritja progresive e të ardhurave të veta vendore, si një burim i rëndësishëm i autonomisë dhe aftësisë së pushtetit vendor për të ofruar shërbime publike cilësore.

Rritja e të ardhurave të veta të njësive të vetëqeverisjes vendore, është tregues i rëndësishëm i kapacitetit fiskal jo vetëm për konsolidimin financiar por edhe për aftësinë për të ofruar shërbime publike në interes të qytetarëve. Thellimi në analizën e kapacitetit sipas njësive të vetëqeverisjes vendore është thelbësor për tu zhvilluar gjatë vitit 2023, me qëllim për të identifikuar kapacitetet e decentralizimit aktual fiskal dhe evidentimin e mundësive të reja në kuadër të këtij procesi. Gjatë vitit 2023, është në objektivat e Ministrisë të evidentojë qartë sa është hapësira fiskale e pa shfrytëzuar aktualisht nga pushteti vendor në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- Forcimi i burimeve të qëndrueshme të të ardhurave të veta vendore

Një ndër treguesit më të rëndësishëm të konsolidimit fiskal të njësive të vetëqeverisjes vendore do të jetë rritja e peshës së burimeve të të ardhurave të veta vendore që janë të qëndrueshme në afatgjatë për pushtetin vendor. Gjatë vitit 2022, pushteti vendor siguroi një rritje sinjifikative të të ardhurave në raport me planin e treguesve fiskal të buxhetit të konsoliduar, tregues ky i kapacitetit në rritje të njësive për të siguruar qëndrueshmërinë e financimit të funksioneve. Në këtë drejtim, Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të ndjekë me prioritet ruajtjen e qëndrueshmërisë së rritjes së të ardhurave vendore edhe gjatë vitit 2023.

- Evidentimi i hapësirave të mundshme dhe përmirësimi i treguesve fiskal të pushtetit vendor krahasuar me vendet europiane të OECD-së.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në objektivat e saj strategjike të cilat janë pjesë e strategjisë së re të decentralizimit fiskal do të synojë të ndjekë treguesit e vendeve të zhvilluara europiane me praktika të mira në qeverisjen vendore. Ashtu sic janë përmirësuar treguesit e të ardhurave të veta, pushteti vendor përmes mekanizmave shtesë duhet të rrisë në vitin 2023 e në vazhdim të gjithë raportet e autonomisë dhe kapacitetit buxhetor në raport jo vetëm me PBB-në por edhe me treguesit financiar publik.

- Rritja e cilësisë së menaxhimit të shpenzimeve publike në nivel vendor

Në kuadër të mirëmenaxhimit financiar në nivel vendor me qëllim për të shmangur trendin e relizimit shumë të madh të shpenzimeve në fund të vitit, kryesisht shpenzimeve për investime, është i nevojshëm rekomandimi përsëri gjatë vitin 2023, për realizimin e shpenzimeve nën një plan të detajuar mujor i cili mundëson disiplinën e shpenzimeve dhe shmangien e mundësisë për krijimin e detyrimeve të prapambetura. Pavarësisht një rritje të vogël të shpenzimeve për investime të pushtetit vendor, përsëri ato mbeten në nivele mjet të ulëta.

- Nxitja e zhvillimi ekonomik lokal dhe ulja e pabarazive midis njësive të vetëqeverisjes vendore.

Duke ju referuar kreut të treguesve të autonomisë vendore evidentohen qartë diferencat ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore në treguesit fiskalë vjetor 2022 por edhe në krahasim me një vit më parë. Përmes politikave të reja të menaxhimit financiar, do të synohet ulja e diferencave dhe sigurimi i një financimi të qëndrueshëm në nivel vendor. Pushteti vendor si pjesë e rëndësishme e zhvillimit ekonomik kombëtar ka në thelb nxitjen e politikave të zhvillimit rajonal. Një ekonomi e fortë lokale në nivel njësie do të përkthehet në një ekonomi të qëndrueshme kombëtare dhe sigurisht mirëqenie me të lartë për qytetarët. Instrumentet financiarë të vetëqeverisjes vendore duhet të orientohen në funksion të zhvillimit ekonomik dhe uljen e pabarazive midis njësive në funksion të zhvillimit kombëtar.




6. Analiza e treguesve fiskal sipas njësive të vetëqeverisjes vendore


6.1 Treguesit e të ardhurave dhe shpenzimeve sipas njësive të vetëqeverisjes vendore

152 Bashkia Belsh

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




102 Bashkia Berat

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




103 Bashkia Bulqizë

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




110 Bashkia Cërrik

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




104 Bashkia Delvinë

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




105 Bashkia Devoll

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




106 Bashkia Dibër

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




147 Bashkia Divjakë

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




452 Bashkia Dropull

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




107 Bashkia Durrës

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




109 Bashkia Elbasan

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




111 Bashkia Fier

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




326 Bashkia Finiq

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




155 Bashkia Fushë-Arrëz

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




115 Bashkia Gjirokastrë

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




114 Bashkia Gramsh

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




117 Bashkia Has

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




160 Bashkia Himarë

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




166 Bashkia Kamëz

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




118 Bashkia Kavajë

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




154 Bashkia Këlcyrë

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




654 Bashkia Klos

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




120 Bashkia Kolonjë

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




156 Bashkia Konispol

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




122 Bashkia Korçë

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




123 Bashkia Krujë

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




124 Bashkia Kuçovë

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




125 Bashkia Kukës

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




126 Bashkia Kurbin

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




127 Bashkia Lezhë

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




116 Bashkia Libohovë

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




128 Bashkia Librazhd

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




129 Bashkia Lushnjë

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




130 Bashkia Malësi e Madhe

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




168 Bashkia Maliq

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




132 Bashkia Mallakastër

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




131 Bashkia Mat

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




143 Bashkia Memaliaj

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




132 Bashkia Mirditë

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




112 Bashkia Patos

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




134 Bashkia Peqin

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




135 Bashkia Përmet

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




136 Bashkia Pogradec

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




140 Bashkia Poliçan

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




153 Bashkia Prrenjas

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




137 Bashkia Pukë

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




499 Bashkia Pustec

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




119 Bashkia Rrogozhinë

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




113 Bashkia Roskovec

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




137 Bashkia Sarandë

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




159 Bashkia Selenicë

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




108 Bashkia Shijk

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




141 Bashkia Shkodër

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




139 Bashkia Skrapar

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




142 Bashkia Tepelenë

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




101 Bashkia Tiranë

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




145 Bashkia Tropojë

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




167 Bashkia Dimal

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




157 Bashkia Vau i Dejës

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




146 Bashkia Vlorë

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021




165 Bashkia Vorë

Grafiku: Të ardhurat sipas burimit 2022/2021




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021






**7. Analiza e buxheteve sipas
Këshillave të Qarqeve në të
ardhura dhe shpenzime**

042 Këshilli i Qarkut Berat




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021

046 Këshilli i Qarkut Dibër




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021

047 Këshilli i Qarkut Durrës




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021

048 Këshilli i Qarkut Elbasan




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021

049 Këshilli i Qarkut Fier




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021

011 Këshilli i Qarkut Gjirokastrë




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021

018 Këshilli i Qarkut Kukës




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021

020 Këshilli i Qarkut Lezhë




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021

033 Këshilli i Qarkut Shkodër




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021

035 Këshilli i Qarkut Tiranë




Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021

037 Këshilli i Qarkut Vlorë



Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021

015 Këshilli i Qarkut Korçë



Grafiku: Shpenzimet sipas natyrës ekonomike 2022/2021



